



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KRYEMINISTRIA
ZËVENDËSKRYEMINISTRI PËR
PUSHTETIN VENDOR



RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT 2024

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR
DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN VENDORE



DECENTRALIZIMI
DHE AFËRSIA



QEVERISJE E MIRË
DHE LLOGARIDHËNIE



BASHKËPUNIM
NDËRSEKTORIAL



ZHVILLIM
I QËNDRUESHËM

Përmbajtja

Lista e shkurtimeve	3
1. Përmbledhje Ekzekutive.....	5
2. Përgatitja e Raportit të Monitorimit	9
2.1 Metodologjia.....	9
2.2 Metodologjia e Hartimit të Raportit.....	9
2.3 Procedura për analizimin e të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës	10
2.4 Pjesëmarrja e aktorëve në përgatitjen e raportit	10
3. Vlerësim i përgjithshëm mbi ecurinë e zbatimit të strategjisë.....	11
Analizë e arritjeve	13
QP1 - Promovimi dhe forcimi i zhvillimit të qendruar.....	13
QP2 – Përmirësimi i cilësisë dhe ofertës së shërbimeve.....	13
QP3 – Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së shërbimeve vendore.....	14
QP4 – Rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i sistemeve të buxhetimit	14
QP5 – Integrimi evropian i agjendës vendore.....	14
QP6 – Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve vendore	14
4. Analiza e progresit drejt 6 qëllimeve politike.....	17
4.1 QP1: Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor	17
4.2 QP2: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardit të ofrimit të tyre për qytetarët.....	27
4.3 QP3: Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre.....	42
4.4 QP4: Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale	45
4.5 QP 5: Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor 52	
4.6 QP6: Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore dhe i një koordinimi e qeverisjeje funksionale gjithëpërfshirëse të aktorëve të decentralizimit	57
QP1. Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor Niveli i realizimit për vitin 2024: 67%	67
QP2. Përmirësimi i cilësisë dhe standardeve të shërbimeve publike vendore Niveli i realizimit për vitin 2024: 79%	68
QP3. Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre.....	68
QP4. Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale Niveli i realizimit për vitin 2024: 46%	69
QP5. Demokracia vendore dhe integrimi evropian Niveli i realizimit për vitin 2024: 66%	70
QP6. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve Niveli i realizimit për vitin 2024: 73% <i>Arritjet kryesore</i>	70
Përfundime	71
Rekomandime	72
Ankes 1.....	75

Lista e shkurtimeve

AFMIS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Financave
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
BPE	Bashki Për Evropë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPMZSH	Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
KB	Këshilli Bashkiak
KK	Këshilli Konsultativ
KKDM	Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha
KM	Këshilli i Ministrave
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
MA	Ministria e Arsimit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MIE	Ministria e Inovacionit dhe Energjisë
MSHPV	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJVNR	Njësia e Vlerësimit të Referimit të Rasteve
OS	Objektiv Specifik
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
Pp	Pikë Përqindje
QP	Qëllim Politik
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TP	Tregues Performace
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
SNDQV	Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

Hyrje

Raporti i monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030 dhe të Planit të Veprimit 2023–2025, për vitin e raportimit 2024, është përgatitur nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV). Përgatitja e këtij raporti përbën një detyrë funksionale të Agjencisë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 227, datë 09.04.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”.

Ky dokument pason raportin e vitit 2023 dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm në procesin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Krahas të dhënave të mbledhura nga institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, raporti i vitit 2024 përfshin gjithashtu një analizë krahasuese të nivelit të realizimit të masave, objektivave strategjike dhe qëllimeve politike në raport me vitin paraprak. Ky proces krahasimi do të finalizohet në raportin e vitit 2025, me mbylljen e Planit të Veprimit 2023–2025, i cili do të përmbyllë ciklin e parë të zbatimit të SNDQV.

Kontributi i institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore mbetet thelbësor për garantimin e një procesi monitorimi gjithëpërfshirës, të besueshëm dhe të orientuar drejt përmirësimit të qeverisjes vendore dhe procesit të decentralizimit në vend. Është e rëndësishme të theksohet se cilësia dhe saktësia e përmbajtjes së raportit varen drejtpërdrejt nga niveli i raportimit dhe cilësia e informacionit të përcjellë nga institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Vizioni për qeverisjen vendore dhe decentralizimin është rruga drejt një qeverisje autonome e cila promovon vlera demokratike, orientohet drejt rritjes ekonomike dhe ushtrimit të funksioneve bashkiake në mënyrë efçente. Në kuadër të arritjes së vizionit të **Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030**, janë përcaktuar **gjashtë qëllime politike kryesore**, të cilat përbëjnë bazën e ndërhyrjeve strategjike dhe të masave të parashikuara në planin e veprimit.

Këto qëllime synojnë:

- **Nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm vendor**, duke fuqizuar rolin e bashkive dhe këshillave të qarqeve në shfrytëzimin efektiv të potencialeve lokale ekonomike, sociale dhe kulturore;
- **Përmirësimin e cilësisë dhe standardeve të shërbimeve publike vendore**, përmes forcimit të kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe zbatimit më efikas të funksioneve të tyre;
- **Zgjerimin e qeverisjes digjitale në nivel vendor**, për të garantuar ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë më transparente, efikase dhe me kosto të ulët;
- **Rritjen e autonomisë financiare vendore**, përmes konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta dhe forcimit të pavarësisë fiskale të bashkive;

- **Përmirësimin e demokracisë vendore dhe përparimin e agjendës së integritetit evropian në nivel lokal**, duke nxitur transparencën, llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë;
- **Si dhe zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative**, për të siguruar zbatim efektiv të procesit të decentralizimit dhe përgatitje të qëndrueshme për proceset integruese.

Këto qëllime përbëjnë boshtin kryesor mbi të cilin është ndërtuar procesi i monitorimit dhe raportimit të **SNDQV 2024**, duke mundësuar një analizë të integruar të progresit në nivel strategjik dhe institucional.

1. Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport monitorimi paraqet ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë si dhe produktet specifike të arritura gjatë vitit të dytë të zbatimit të saj. Duke u mbështetur në rezultatet e raportit të monitorimit për vitin 2023, në këtë dokument realizohet gjithashtu krahasimi i nivelit të zbatimit të masave për vitin 2024, me qëllim vlerësimin e progresit dhe identifikimin e fushave që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme.

Bazuar në metodologjinë e hartimit të raportit, fokusi kryesor është vendosur në evidentimin e produkteve dhe rezultateve të arritura në kuadër të çdo objekti specifiku të Strategjisë. Një element plotësues i këtij procesi është **Pasaporta e Indikatorëve**, e cila përmban treguesit e performancës që matin ecurinë e agjendës së decentralizimit dhe ndihmojnë në monitorimin e progresit të përgjithshëm.

Ecuria e zbatimit të masave të parashikuara në strategji është në nivele të mira krahasuar edhe me vitin e parë të monitorimit të tyre. Nga 164 masa të caktuara në planin e veprimit për t'u monitoruar për vitin 2024, 35% e tyre mund të konsiderohen të realizuara në vlerën 100% duke iu përmbajtur afatit kohor të planit të veprimit (57 masa).




Numri i masave të planit të veprimit sipas përqindjes së zbatimit

Nga një vështrim i përgjithshëm nga 164 masa vërejmë se 57 masa janë zbatuar në nivelin 100%, 47 masa janë zbatuar në nivelin 51%-99%, 49 masa janë në proces realizimi dhe për 11 masa nuk ka filluar ende zbatimi ose përqindja e zbatimit është shumë e ulët.

Për sa i përket 6 qëllimeve politike kanë patur një ecuri të tillë ku, qëllimi politik nr.1 në zbatimin gjithsej të masave shënon rezultatin prej 67%, qëllimi nr.2 shënon një nivel realizimi prej 79%, qëllimi nr.3 nivel realizimi prej 53%, qëllimi nr.4 nivel realizimi prej 46%, qëllimi politik nr.5 nivel realizimi prej 66%, si dhe qëllimi politik nr.6 shënon rezultatin 73%. Nivelin më të lartë të realizimit e ka QP2 i cili lidhet me përmirësimin i cilësisë, standardeve dhe ofrimit të shërbimeve.

Realizimi i Qëllimit Politik në %



Zbatimi i masave në numër dhe përqindje për vitin 2024

Rezultatet kryesore të arritura në vitin e dytë të zbatimit të Strategjisë janë:

1. Përmbushja në masën 79% e qëllimit politik nr.2 në nivelin më të lartë krahasuar me qëllimet e tjera politike evidenton vullnetin e institucioneve përgjegjëse për përmirësimin i cilësisë, standardeve dhe ofrimit të shërbimeve.
2. U finalizuan dhe avancuan disa procese kyçe, përfshirë:
 - Funksionalizimin e aplikacionit TEA për menaxhimin e të dhënave të trashëgimisë kulturore;
 - Rritjen e numrit të bashkive që zbatojnë plane të mbarështimit të pyjeve.
3. Gjithashtu, është përmirësuar kuadri rregullator dhe instrumentet mbështetëse për NJVV-të. Gjatë vitit është finalizuar një paketë dokumentesh orientuese dhe rregullatore (manuale organizative, udhëzues cilësie, rregullore sektoriale,

projektiligje), të cilat rrisin kapacitetet e bashkive dhe vendosin standarde të qarta në ofrimin e shërbimeve.


4. Gjatë vitit 2024 janë vendosur themelet e rëndësishme për transformimin digjital të shërbimeve vendore: është ngritur Grupi i përbashkët i punës për ri-inxhinierimin e shërbimeve, është miratuar lista e shërbimeve prioritare për digjitalizim, dhe janë dakordësuar me Bankën Botërore hapat teknikë dhe institucionalë për zbatimin e programit GovTech AF. Këto zhvillime përbëjnë një hap të rëndësishëm për përgatitjen e integritit të shërbimeve vendore në platformën e-Albania 2.0 deri në vitin 2027.
5. Gjithashtu, janë zhvilluar një numër i lartë trajnimesh, sesione informuese dhe programe mbështetëse, të cilat kanë rritur kapacitetet e këshillave bashkiakë, njësive të integritetit, administratës vendore dhe strukturave të integritetit evropian. Kjo ka kontribuar drejtpërdrejt në profesionalizimin e burimeve njerëzore në nivel lokal.
6. Realizimi i plotë i disa masave, si plani i integritetit, udhëzimet praktike, ngritja dhe funksionimi i komisioneve, si dhe rritja e pjesëmarrjes së administratës vendore në proceset e integritetit evropian, ka sjellë përmirësim të dukshëm në standardet e qeverisjes vendore, duke rritur transparencën, llogaridhënien dhe cilësinë e vendimmarrjes.

Vlejnë të përmenden sfidat e hasura në zbatimin e planit të veprimit gjatë vitit të dytë të raportimit:

- **Mungesa e kapaciteteve dhe të dhënave në nivel vendor**
 1. Mungesa e raportimit nga 17 bashki;
 2. Disa bashki nuk raportojnë ose nuk kanë kapacitete të plota për të zbatuar detyrimet (p.sh. inventarizimi i aseteve, raportet e kapitalit natyror, menaxhimi i ujitjes, strukturat e turizmit);
- **Diferenca në ritmet e zbatimit**
 1. Disa masa që kërkojnë bashkërendim qendror–vendor nuk kanë avancuar në të njëjtin ritëm në të gjitha bashkitë;
 2. Ka diferenca në kapacitetet teknike, burimet njerëzore dhe aftësitë për të ndjekur proceset rregullatore nga NJVV-të.
- **Shndërrimi i trajnimeve dhe ndërhyrjeve në performancë të qëndrueshme**
 1. Megjithëse ka avancim në trajnime dhe ngritje kapacitetesh, sfida mbetet që këto të reflektohen në përmirësime të matshme dhe të qëndrueshme në performancën e përditshme të administratës vendore.
- **Diferenca në adaptimin e praktikave të reja**
 1. Disa bashki adaptojnë më shpejt proceset e reja, ndërsa të tjera lëvizin më ngadalë për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, ekspertizës ose kapaciteteve organizative.


Duke qenë se tashmë kemi edhe raportin e monitorimit për vitin 2023, mund të theksojmë progresin pozitiv në zbatimin e masave për të gjitha qëllimet politike.

Krahasuar me vitin 2023, këtë vit shënojmë 35 masa të realizuara plotësisht, nga 22 masa të realizuara në vitin 2023. Gjithashtu, vërehet një ulje e numrit të masave që nuk kanë nisur ende zbatimin, nga 16 masa në vitin 2023 në vetëm 7 masa këtë vit.



Përqindja e masave të planit të veprimit sipas viteve 2023-2024

Realizimi i Qëllimeve Politike sipas Objektivit Specifik



Progresi në realizim i Strategjisë sipas Qëllimeve Politike (% masave sipas statusit të zbatimit)

2. Përgatitja e Raportit të Monitorimit

2.1 Metodologjia

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është institucioni përgjegjës për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit, përfshirë masat, indikatorët e performancës dhe aspektet e financimit. Në zbatim të VKM nr. 227, datë 09.04.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”, si dhe të urdhrit të Kryeministrit nr. 83, datë 20.05.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”, **Sektori i Decentralizimit**, pranë Drejtorisë së Kuadrit Ligjor dhe Decentralizimit, është përcaktuar si njësi përgjegjëse për procesin e monitorimit dhe hartimin e raporteve periodike të Strategjisë Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2023–2030.

Ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore janë ngarkuar me detyrimin për të garantuar zbatimin e masave dhe objektivave, si edhe për të siguruar informacionin e nevojshëm për procesin e monitorimit. Sipas Planit të Veprimit 2023–2025, NJVV-të janë përgjegjëse për zbatimin e 40 masave, ndërsa përgjegjëse kryesore për 27 prej tyre. Kostot indikative të parashikuara për zbatimin e këtyre masave për periudhën 2023–2025 janë 3.921.658.691 lekë, nga të cilat 87% mbulohen nga PBA-të e NJVV-ve dhe 4% nga donatorët, ndërsa hendeku financiar (pjesa e pafinancuar) përbën 9% të totalit.

Institucionet qendrore janë përgjegjëse kryesore për masat e Planit të Veprimit me një kosto indikative prej 6.139.400.017 lekë, ku 84% mbulohet nga PBA-të e institucioneve dhe 15% nga donatorët. Hendeku financiar për këtë grup masash përbën 2% të totalit.

Raporti i monitorimit për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2024 është hartuar mbi bazën e të dhënave të siguruara nga institucionet përgjegjëse dhe ato kontribuese në Planin e Veprimit. Raporti ofron një panoramë të gjerë të funksioneve dhe shërbimeve kryesore të NJVV-ve dhe institucioneve qendrore, si edhe një analizë të detajuar të treguesve financiarë.

Raportet e monitorimit janë vjetore dhe shërbejnë si një instrument thelbësor informimi për politikëbërësit, duke ofruar në kohë të dhëna mbi progresin e zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit të SNDQV-së dhe duke mbështetur planifikimin për vitin pasardhës.

2.2 Metodologjia e Hartimit të Raportit

Vlerësimi i ecurisë së Qëllimeve Politike dhe Objektivave Specifikë bazohet në nivelin e raportuar të zbatimit, financimit dhe riskut të masave që përmban secili objektiv nga institucionet përgjegjëse. Përcaktimi i statusit të progresit për çdo objektiv realizohet sipas kodeve dhe pragjeve të përcaktuara në Guidën e Mirëqeverisjes, si vijon:

- Dobët – kur vetëm 0–5% e masave të planifikuara janë realizuar;
- Mirë – kur 6–50% e masave të planifikuara janë realizuar;

- Shumë mirë – kur 51–100% e masave të planifikuara janë realizuar.

Masat që janë në përgjegjësi zbatimi të NJVV-ve konsiderohen të realizuara plotësisht kur zbatimi është arritur nga një pjesë e bashkive, duke krijuar një model të qartë pikënisjeje për aktivitetin përkatës.

Në rastet kur përgjegjësia për zbatimin dhe raportimin e një mase është e ndarë mes institucioneve qendrore dhe atyre vendore, paraqitja grafike bazohet në të dhënat e raportuara nga institucioni qendror. Rezultati më pas krahasohet dhe interpretohet në kuadër të objektivit përkatës.

2.3 Procedura për analizimin e të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

- E zbatuar: Është raportuar statusi “E zbatuar” për ato masa/produkte të cilat janë përmbushur;
- Pjesërisht e zbatuar/Në proces: Është raportuar statusi “Në proces” për ato masa/produkte, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre;
- E pazbatuar: Të pazbatuara janë raportuar ato masa/produkte të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk ka pasur progres.

Pasaporta e indikatorëve të performancës është vlerësuar duke i krahasuar vlerat e raportuara aktuale për vitin e raportimit, me vlerën e synuar në vitin përkatës. Për vitin 2024 raportohet tendenca për tregues sipas vlerës nga raportimi i 2023 ku është përfshirë edhe krahasimi me këtë vit dhe ecuria e këtyre treguesve.

2.4 Pjesëmarrja e aktorëve në përgatitjen e raportit

Mbledhja e të dhënave nga pyetëtorët përbën një nga fazat më të rëndësishme të procesit të monitorimit të Strategjisë së Decentralizimit. Të dhënat e mbledhura nga institucionet qendrore dhe nga bashkitë janë burimi kryesor për monitorimin e masave, treguesve dhe objektivave financiarë.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë plotësuar pyetëtorin e përgatitur, i cili përfshinte produktet specifike për çdo masë. Fillimisht, është plotësuar formati Excel i shpërndarë nga personat e kontaktit të caktuar për raportimin në bashki, sipas drejtorive përkatëse. Edhe ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore kanë ndjekur një proces të ngjashëm me atë të NJVV-ve, me ndryshimin se pyetëtorët e tyre ishin të personalizuar për masat përkatëse të secilit institucion. Të dhënat për çdo masë janë plotësuar në format Excel, të cilat më pas janë grumbulluar dhe analizuar në funksion të hartimit të raportit.


Grumbullimi i të dhënave ka rezultuar një nga sfidat kryesore të procesit, për shkak të ngarkesës së NJVV-ve me detyra të përditshme, si edhe të angazhimeve të tyre në raportime apo kontrole nga organet audituese, të cilat shpesh janë zhvilluar paralelisht me procesin e monitorimit të strategjisë. Megjithatë, pavarësisht këtyre vështirësive, është arritur të sigurohet një nivel i kënaqshëm i raportimit nga bashkitë.

Sa i përket ministrive të linjës dhe agjencive të tyre, vonesat në raportim janë shkaktuar kryesisht nga lëvizjet e stafit, konkretisht largimi nga detyra i punonjësve që kanë qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e strategjisë.

Në përfundim të procesit të mbledhjes së të dhënave, informacioni u sigurua nga **44 NJVV** dhe nga **17 institucione qendrore**, të cilat kanë dorëzuar të gjitha të dhënat e kërkuara.

3. Vlerësim i përgjithshëm mbi ecurinë e zbatimit të strategjisë

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV) përmbyll vitin e saj të dytë të monitorimit për periudhën raportuese 2024. Ky raport paraqet ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë 2023–2025, duke përcaktuar statusin e masave dhe objektivave specifikë. Plani i Veprimit për vitin 2023–2024 përfshin 164 masa, 22 objektiva dhe 13 indikatorë performance. Nga 164 masat në monitorim, për 96 masa ka filluar zbatimi dhe ato ndodhen në fazë realizimi, me një nivel që varion nga 6% deri në 99%. Ndërkohë, 57 masa janë realizuar plotësisht, nga të cilat disa janë përmbyllur që gjatë vitit 2023. Vetëm 11 masa rezultojnë të jenë jashtë afatit, pasi për to nuk ka nisur ende procesi i zbatimit.



Zbatimi i masave në numër dhe përqindje



Numri i masave të planit të veprimit sipas përqindjes së zbatimit


Referuar grafikut, në nivel **qëllimesh politike** progresi më i lartë vërehet në **shtyllën e dytë**, e cila lidhet me përmirësimin e cilësisë, standardeve dhe ofrimit të shërbimeve vendore. Kjo shtyllë paraqet numrin më të lartë të masave të realizuara gjatë periudhës së raportimit dhe njëkohësisht ka edhe numrin më të madh të masave të parashikuara për qëllim politik, krahasuar me shtyllat e tjera të Strategjisë.

Gjithashtu, një ecure pozitive dhe përtej pritshmërive shënohet edhe në **shtyllën e gjashtë**, e cila lidhet me përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, të shoqëruar me rritje të kapaciteteve administrative dhe profesionale të NJVV-ve.

Qëllimet politike	QP1	QP2	QP3	QP4	QP5	QP6
Masa 100% (2024)	10	28	1	1	6	11
Masa 51%-99% (2024)	7	18	2	9	2	9
Masa 6%-50% (2024)	8	18	8	14	0	1
Masa 0%-5% (2024)	5	2	0	2	0	2

Numri i masave të zbatuara për 6 Qëllimeet Politike

Niveli i realizimit të masave sipas Qëllimeve Politike



Realizueshmëria e masave për Qëllim Politik

Analizë e arritjeve

Duhet të theksojmë se, në nivel objektiv specifik, krahasimet duhet të bëhen me kujdes, pasi numri i masave ndryshon ndjeshëm nga një objektiv në tjetrin. Siç vërehet edhe nga grafiku i mëposhtëm, QP 2 ka 28 masa të realizuara 100%, por njëkohësisht ka edhe numrin më të lartë të masave në total, me 66 masa. Sa i përket nivelit të realizimit të masave, ecuria më e dobët vërehet tek QP 3 dhe QP 4, ku një numër i konsiderueshëm masash janë mbrapa me planin e veprimit dhe ndodhen në fazën e realizimit nga 6% deri në 50%.

QP1 - Promovimi dhe forcimi i zhvillimit të qendruar

- Realizimi i masave është mesatar: 10 masa 100%, 7 masa 51-99%, 8 masa 6-50%, dhe 5 masa 0-5%.
- Disa masa kryesore janë përmbushur, por ka ende sfida në zbatimin e plotë.

QP2 – Përmirësimi i cilësisë dhe ofertës së shërbimeve

- Ecuria më e mirë: 28 masa të realizuara 100%.
- Ka numrin më të madh të masave gjithsej (66), që tregon një përpjekje të gjerë reformuese.
- Megjithatë, ka edhe masa në fazën 6–50% dhe 0–5%, që kërkojnë monitorim dhe përmirësim.

QP3 – Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së shërbimeve vendore

- Ecuria më e dobët: vetëm 1 masë 100% realizuar.
- Shumica e masave ndodhen në fazën 6–50%, duke treguar vonesa në zbatimin praktik.

QP4 – Rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i sistemeve të buxhetimit


- Po ashtu ka realizim të mirë: vetëm 1 masë 100%, 9 masa 51–99%, dhe 14 masa 6–50%.
- Tregon sfida në konsolidimin e instrumenteve financiare dhe kapaciteteve lokale për implementim.

QP5 – Integrimi evropian i agjendës vendore

- Realizimi është më i ulët se QP2 dhe QP1, por disa masa janë të plota (6 masa 100%).
- Nuk ka masa në nivel 6–50%, por disa në fazën 51–99%.

QP6 – Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve vendore


- Një nivel i mirë realizimi: 11 masa 100%, 9 masa 51–99%.
- Ka vetëm disa masa në nivelin më të ulët, që sugjeron nevojën për fokus në përmirësimin e kapaciteteve vendore.



Niveli i realizimit të masave sipas objektivave për çdo Qëllim Politik

4. Analiza e progresit drejt 6 qëllimeve politike

Në vijim paraqitet një analizë e detajuar e objektivave dhe masave kryesore për të cilat është shënuar progres në zbatimin e Planit të Veprimit, sipas çdo qëllimi politik. Në figurën e mëposhtme jepet, në mënyrë të përmbledhur, përqindja e realizimit për secilin Qëllim Politik. Në Shtojcën nr. 1 paraqitet informacioni narrativ i detajuar për çdo masë të objektivave specifike.




Realizimi i Qëllimeve Politike në përqindje

4.1 QP1: Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor


Statusi i zbatimit të qëllimit të parë politik të agjendës së strategjisë, është realizuar në **masën 67%**. Në figurën 6 paraqiten katër objektivat specifike për QP.1, me masat përkatëse të detajuara në numër dhe përqindje realizimi total për çdo masë që ka objektivi specifik. Nga pikëpamja e përgjithshme kemi një realizim objektivash shumë të mirë lidhur me realizimin e produkteve për masë.

Objektivi Specifik	1.1	1.2	1.3	1.4
E pa gjurmuar	0	0	0	0
Pa filluar	1	0	0	0
Me vonesë	2	3	1	0
Në kohë	2	2	7	2
Përfunduar	1	3	4	2
Gabim	0	0	0	0
Realizimi në Përqindje (%)	58%	65%	74%	73%
Statusi i Objektivit	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë

Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP1



Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP1



Zbatueshmëria e masave të QP1

Masa 1.1.1 “Përfundimi i procesit të hartimit të planeve të përgjithshme vendore, rishikimi i planeve të miratuara dhe hartimi i planeve strategjike zhvillimore” 44 NJVV kanë raportuar për vitin 2024 nga të cilat 43 prej tyre kanë plane të përgjithshme vendore, ndërsa bashkia Dropull është në proces miratimi. Për sa i përket planeve strategjike zhvillimore nga Këshilli Bashkiak për vitin 2024 rezultojnë 15 bashki të cilat kanë miratuar në KB planet, përkatësisht bashkitë: Elbasan, Belsh, Pogradec, Fier, Mallakastër, Dimal, Klos, Vau i Dejës, Tiranë, Lezhë, Librazhd, Dibër, Konispol, Pukë, Tepelenë.

- **Realizimi 2023:** 80% | **Realizimi 2024:** 90%
- **Progres +10 pp** – finalizuar nga 15 bashki miratimi i planeve strategjike zhvillimore

Masa 1.1.2 “Rijetëzimi dhe prezantimi i incentivave apo skemave të reja për marrëveshjet ndërvendore dhe me aktorë të tjerë joqeveritare” ka shënuar përparim të dukshëm gjatë vitit 2024, në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërvendore dhe qeverisjes vendore, ashtu edhe të krijimit të instrumenteve të strukturuar nxitëse. Përveç marrëveshjeve ndërvendore të realizuara ndërmjet bashkive për punësimin sezonal të punonjësve, si dhe bashkëpunimeve me organizata ndërkombëtare si IOM dhe institucione akademike (universitete), një hap thelbësor ka qenë konceptimi dhe formalizimi i Grantit të Bazuar në Performancë si akt normativ që lidh rezultatet me mbështetjen financiare.

Realizimi 2023: 80% | Realizimi 2024: 90%

➤ **Progres +10 pp.**

Masa 1.1.3 *“Rishikimi i kuadrit ligjor për skemat vendore/praktikat e mbështetjes dhe bashkëpunimit me bizneset”, ka shënuar progres të dukshëm gjatë vitit 2024. Është iniciuar procesi i konsultimit ndërinstitucional dhe mbledhja e praktikave ekzistuese të bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe bizneseve, duke hedhur bazat për rishikimin dhe unifikimin e kuadrit ligjor në nivel vendor.*

➤ **Realizimi 2023: 0% | Realizimi 2024: 35%**

➤ **Progres +35 pp** - ngritur grupi ndërinstitucional për rishikimin e kuadrit ligjor mbi shoqëritë vendore shtetërore dhe nisur procesi i konsultimit ndërinstitucional për unifikimin e praktikave të bashkëpunimit bashki–biznes.

Masa 1.1.4 *“Qartësim i hapësirave/mbivendosjeve ligjore për rijetësimin e shoqërive tregtare”, nëpërmjet hartimit të dokumentit orientues në mbështetje të përgatitjes së projektligjit “Për Ndërmarrjet Publike Vendore”, ka adresuar analizën e gjendjes aktuale, problematikave dhe praktikave krahasuese ndërkombëtare.*

➤ **Realizimi 2023: 0% | Realizimi 2024: 35%**

➤ **Progres +35 pp** - hartuar dokument analitik orientues në mbështetje të projektligjit “Për Ndërmarrjet Publike Vendore”.

Masa 1.1.6 *“Identifikimi i vazhdueshëm i praktikave të mira të lidhura me bashkëpunimin bashki-biznes dhe inkurajimi e orientim i bashkive për replikim apo përshtatje sipas rastit”, gjatë vitit 2024 ka vijuar me identifikimin dhe promovimin e modeleve të suksesshme të bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe komunitetit të biznesit, që synojnë rritjen e efikasitetit dhe inovacionit në ofrimin e shërbimeve publike vendore. Ndër praktikatat më të spikatura mund të përmenden:*

- Bashkia Elbasan, për instalimin e paneleve fotovoltaike me qëllim uljen e kostove të energjisë;
- Bashkia Tiranë, për rikualifikimin e godinave ekzistuese në çerdhe dhe kopshte në zonat ku mungojnë këto institucione;
- Bashkia Korçë, për menaxhimin e organizuar të qendrave sociale, si model i mirë për replikim në bashki të tjera;
- Agjencia për Administrimin e Tregjeve në varësi të bashkisë Tiranë, për menaxhimin e tregjeve publike me fokus reduktimin e informalitetit dhe përmirësimin e standardeve të shërbimit.

Gjithashtu, nga Drejtoria e Integrimit Evropian dhe Projekteve janë evidentuar praktika shtesë si: Qendra multifunksionale e Bashkisë Lushnjë, menaxhimi efektiv i projekteve nga Bashkia Përmet dhe realizimi i plotë i fondeve sociale nga bashkia Kamëz. Në nivel rajonal, Shoqëria

“KRËM – Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë” përfaqëson një model të konsoliduar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke siguruar depozitimin sanitar sipas standardeve evropiane dhe duke kontribuar në riciklim dhe ndërgjegjësim qytetar.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 1.2.1 “Shfrytëzimi i aseteve vendore, si instrument i rritjes ekonomike vendore dhe burim i gjenerimit të të ardhurave. Identifikim, vlerësim dhe klasifikim të pronave të bashkive (inventarizim nga secila bashki)”. Shumica e bashkive disponojnë një inventar fizik të aseteve, megjithatë shfaqet në nivele më të ulëta kontabilizmi dhe aftësia për të gjeneruar të ardhura prej tyre.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 1.2.2 “Strategji/Plan të vënies në përdorim të aseteve vendore nga ana e bashkive (përcaktimin e burimeve financiare dhe politikave fiskale që mbështesin zbatimin e strategjisë/planit)”, është e lidhur me masën e mëparshme ku nga këto bashki të cilat kanë një inventar të aseteve të ndodhura në territorin e bashkisë, për vitin 2024 rezultojnë 3 bashki (Belsh, Finiq, Vorë) të kenë miratuar plane për vënien në përdorim të aseteve për gjenerimin e të ardhurave. Nga raportimi i viti 2023, masa rezulton me rritje 5 pikë përqindje.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka ndikuar në mënyrë të tërthortë në zbatimin e kësaj mase përmes krijimit të bazës së parë të standardizuar të të dhënave mbi asetet natyrore dhe potencialet e tyre ekonomike në nivel vendor. Përmes vlerësimeve të kapitalit natyror në gjashtë bashki pilote dhe zhvillimit të manualit zyrtar metodologjik, OSBE ka ndihmuar bashkitë dhe Ministrin e Pushtetit Vendor/ AMVV të identifikojnë burimet ekonomike të pashfrytëzuara, potencialet për të ardhura nga qiratë, taksat e përdorimit, hapësirat rekreative, energjinë e rinovueshme dhe instrumentet fiskale vendore. Kjo punë paraprake i ka mundësuar katër njësive të vetëqeverisjes vendore të kenë tashmë informacionin e nevojshëm për të hartuar plane të vënies në përdorim të aseteve natyrore, siç kërkohet nga Strategjia e Decentralizimit.

➤ **Realizimi 2023:** 35% | **Realizimi 2024:** 40%

➤ **Progres +5 pp** – finalizuar nga 3 bashki të cilat kanë strategji/plan për vënien në përdorim të aseteve.

Masa 1.2.3 “Bashkëpunim të zgjeruar ndërinstitucional në lehtësimin e procesit të transferimit të pronave publike tek NJVV me qëllim rritjen e ekonomisë vendore”. Në vazhdimësinë e procesit të transferimit të pronave, bashkëpunimet ndërinstitucionale midis pushtetit vendor dhe pushtetit qendror, si dhe marrëveshjet e lidhura midis NJVV-ASHK kanë lehtësuar procesin e transferimit të pronave publike.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 1.2.5 “*Rijetësimi i aseteve natyrore (si pyjet dhe kullotat apo fondi i tokës bujqësore)*”. Në përgjithësi, NJVV-të kanë raportuar një zbatim të pjesshëm të masës me përqendrim më të lartë në mirëmbajtje dhe plane menaxhimi sesa në ndërhyrje për rijetësim. Bashkitë kanë hartuar dhe miratuar për vitin 2024 plane të mbarështimit të pyjeve me qëllim rijetësimin e aseteve natyrore, (Cërrik, Elbasan, Dimal, Kamëz, Librazhd, Prrenjas, Shijak, Tepelenë, Dropull, Fushë-Arrëz, Kolonjë, Mat, Pogradec, Pukë, Vau i Dejës).

OSBE ka mbështetur zbatimin e kësaj mase duke realizuar një analizë të thelluar të gjendjes së pyjeve, kullotave, tokave bujqësore dhe ekosistemeve të tjera në katër bashki pilote. Nëpërmjet hartëzimit, vlerësimit sasior, cilësor dhe monetar, janë identifikuar zonat dhe potencialet për restaurim, ripërdorim bujqësor, rigjenerim pyjor, zhvillim rekreativ dhe turizëm natyror. Këto rezultate kanë ndihmuar Ministrinë dhe bashkitë të përgatiten për ndërhyrje restauruese në funksion të mbrojtjes së ekosistemeve dhe përdorimit të qëndrueshëm të aseteve natyrore.

- **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 60%
- **Progres +10 pp** – 15 bashki kanë miratuar plane mbarështimi pyjesh në kuadër të rijetësimin të aseteve natyrore, masa në proces të zbatimit të këtyre planeve.

Masa 1.2.6 “*Koordinim ndërbashkiak në drejtim të planeve të përbashkëta të mbarështimit të pyjeve me qëllim zhvillimin ekonomik vendor*”. Në kuadër të procesit të hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve bashkitë kanë rritur bashkëpunimin ndërbashkiak me qëllim zhvillimin ekonomik vendor, bashkitë që bëjnë pjesë në planin e mbarështimit me koordinimin ndërmjet tyre janë: Vau i Dejës, Fier, Devoll, Gramsh, Pogradec, Përmet, Dropull, Berat, Elbasan, Prrenjas, Librazhd, Mirditë dhe Gjirokastrë.

- **Realizimi 2023:** 10% | **Realizimi 2024:** 30%
- **Progres +20 pp** – vihet re një rritje e pjesshme e bashkëpunimit ndërbashkiak.

Masa 1.2.8 “*Vlerësimi i kapitalit natyror për secilën bashki sipas metodologjisë së miratuar*”. OSBE ka realizuar kontributin më të rëndësishëm për këtë masë, duke ndërtuar metodologjinë kombëtare të vlerësimit të kapitalit natyror, duke e pilotuar atë në bashkitë Mat, Pogradec, Roskovec dhe Selenicë, dhe duke i bërë rezultatet pjesë të një modeli zyrtar referues për zbatimin kombëtar. Për të siguruar kapacitete të qëndrueshme në nivel kombëtar, OSBE ka trajnuar 128 specialistë nga 58 bashki në përdorimin e metodologjisë, hartëzimin e burimeve, grumbullimin e të dhënave, analizën e shërbimeve të ekosistemit dhe llogaritjen e vlerave monetare të kapitalit natyror. Gjithashtu, në bashkëpunim me AMVV dhe Akademinë e Qeverisjes Vendore, OSBE ka hartuar kurrikulën zyrtare për trajnimin e kapitalit natyror, e cila është miratuar dhe futur në programet zyrtare të formimit të administratës vendore.

- **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 45%
- **Progres +15 pp** – gjatë viti 2024 është shënuar një progress i ulët ku vetëm 4 bashki rezultojnë të kenë hartuar raportin e vlerësimit të kapitalit natyror

Masa 1.2.9 *“Hartim i planit të menaxhimit të kapitalit natyror për secilën bashki”, OSBE së bashku me AMVV kanë hartuar Vlerësimin Analitik të Funksioneve dhe Kompetencave Ligjore të Bashkive për Burimet Natyrore, dokument i cili për herë të parë përcakton qartë mandatin, përgjegjësitë, kufizimet dhe hapësirat ligjore të bashkive në menaxhimin e kapitalit natyror. Ky vlerësim ka ndërtuar rrugëzimin juridik dhe institucional që i mundëson bashkive të hartojnë Plane të Menaxhimit të Kapitalit Natyror, në përputhje me metodologjinë e miratuar, kompetencat që u njeh ligji dhe objektivat e Strategjisë së Decentralizimit 2023–2030. Dokumenti shërben si model orientues kombëtar për bashkitë në planifikimin 5–10 vjeçar të burimeve natyrore, prioritarizimin e investimeve dhe integrimin e shërbimeve të ekosistemit në politikat vendore.*

- **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 45%
- **Progres +15 pp** – pasi një numër më i madh bashkish kanë avancuar nga faza e vlerësimit drejt hartimit të planeve të menaxhimit të kapitalit natyror

Masa 1.3.1 *“Nxitja e rolit të bashkisë për mbështetje nëpërmjet financimit me grante dhe lehtësimi për aplikimin në skemat e AZHBR-së” është vijuar me forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e qasjes LEADER në nivel vendor. Aktualisht në Shqipëri janë 6 Grupe Vendore të Veprimit të regjistruara, me rreth 140 anëtarë nga sektorët publik, social dhe ekonomik. Këto grupe mbulojnë 7 bashki (Elbasan, Pogradec, Ersekë, Përmet, Këlcyrë, Roskovec dhe Vlorë), përfshijnë 38 njësi administrative, me një territor prej 3,252.77 km² dhe afërsisht 238,959 banorë.*

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 1.3.2 *“Ngritja e kapaciteteve të bashkive në procesin e krijimit të Grupeve Vendore të Veprimit në kuadrin e masës LEADER të programeve IPARD” është zbatuar nga Autoriteti Menaxhues i IPARD, me mbështetjen e FAO-s, përmes zhvillimit të 6 Workshop-eve rajonale që synuan rritjen e ndërgjegjësimit dhe ngritjen e kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore dhe GVV-ve. Këto trajnime adresuan nevojat për përgatitjen dhe zbatimin e Strategjive të Zhvillimit Lokal dhe krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit publik–privat në nivel lokal. Në vijim, parashikohet krijimi i 4 GVV-ve të reja dhe hartimi i udhëzimeve metodologjike për funksionimin dhe menaxhimin e strategjive vendore të zhvillimit.*

- **Realizimi 2024:** 60%
- **Progres +60 pp** - zhvilluar 6 workshop-e rajonale për ngritjen e kapaciteteve të bashkive dhe GVV-ve në kuadër të qasjes LEADER, duke rritur ndërgjegjësimin institucional dhe aftësitë për përgatitjen e Strategjive të Zhvillimit Lokal (LDS);

Masa 1.3.3 *“Nxitja e rolit të bashkive dhe konsolidimi i kapaciteteve të tyre në administrimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit, duke e mbështetur edhe nëpërmjet financimeve nga qeveria qendrore, si dhe fuqizimin e bashkërendimit të politikave për zhvillimin e rrjeteve parësore nën administrimin e MBZHR-së, atyre dytësore dhe tretësore nën kompetencën bashkiake” është*

finalizuar përmes përgatitjes së akteve ligjore dhe nënligjore në mbështetje të menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit të transferuar në pronësi të bashkive, si më poshtë:

- Ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”;
- Urdhri nr.370, datë 11.6.2019, “Për miratimin e statutit tip të Organizatës së Përdoruesve të Ujit”;
- Urdhri nr.535, datë 27.9.2019, “Për miratimin e marrëveshjes tip të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor”;
- Udhëzimi nr.12, datë 30.12.2019, “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”;
- Urdhri nr.697, datë 30.12.2019, “Për miratimin e regjistrave të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit”
- VKM nr.345, datë 22.5.2019, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Ujitjes dhe të Kullimit 2019–2031”.

➤ **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 100%

➤ **Progres +70 pp** - finalizuar kuadri ligjor dhe nënligjor për administrimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit, duke konsoliduar bazën institucionale dhe teknike për bashkitë. Zbatimi vijon përmes investimeve dhe instrumenteve të performancës në nivel vendor.

Masa 1.3.5 “Kryerja e studimit të parafisibilitetit të rreth 430 digave për sigurinë e digave dhe përdorimit të tyre për ujitje, mbështetur në studimet e mëparshme (për 195 diga) të sigurisë së digave” për efekt të kalimeve në menaxhimin e fondit grant të studimit të digave nga WBIF (Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor), tek Banka Botërore, fillimi i projektit është shtyrë dhe parashikohet të nisë në vitin 2024, me synim përfundimin në vitin 2026.

Ky studim do të shërbejë si bazë teknike për identifikimin e nevojave për ndërhyrje, priorizimin e investimeve të ardhshme dhe përmirësimin e menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes, duke kontribuar në rritjen e sigurisë së digave dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.”

➤ **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 30%

➤ **Nivel i qëndrueshëm**, pa ndryshim krahasuar me vitin paraardhës;

Masa 1.3.6 “Rritja e sigurisë së digave, nëpërmjet rehabilitimit/rikonstruksionit të digave, duke filluar nga ato me rrezikshmëri të lartë”. Në zbatim të kësaj mase për digat me rrezikshmëri të lartë, bashkitë kanë ndërmarrë veprime për rehabilitimet e tyre. Për vitin 2024 raportohen 50 diga me rrezikshmëri të lartë, ku numri më i lartë evidentohet në 5 bashki, Berat, Mat, Kolonjë, Maliq, Vorë. Megjithatë sfidë mbetet vlerësimi teknik për rrezikshmërinë e digave.

➤ **Realizimi 2023:** 20% | **Realizimi 2024:** 49%

- **Progres +29 pp** - i reflektuar nga rritja e ndërhyrjeve rehabilituese në digat me rrezikshmëri të lartë dhe nga zgjerimi i numrit të bashkive që kanë raportuar veprime konkrete gjatë vitit 2024, ndonëse vlerësimi teknik i rrezikshmërisë mbetet një sfidë e vazhdueshme.

Masa 1.3.10 “*Performanca e ofrimit të shërbimit të ujitjes dhe të kullimit nga NJVV, nëpërmjet popullimit me të dhëna të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Ujitjes dhe të Kullimit nga vetë NJVV (ujitja.al) dhe vlerësimi i performances*”. Portali “ujitja.al” është i aksesueshëm por nuk paraqet të dhëna raportuese.

- **Realizimi 2023:** 54% | **Realizimi 2024:** 65%
- **Progres +11 pp** - pasi megjithëse portali “ujitja.al” nuk paraqet ende të dhëna raportuese edhe pse një numër më i madh i bashkive janë përmirësuar në aspektin e përpunimit të të dhënave dhe gatishmërisë institucionale për raportim.

Masa 1.3.12 “*Promovimi i nismave në nivel bashkie dhe qarku për mbarështimin e pyjeve dhe ruajtjen e tyre*”. Nisur nga nismat qeveritare dhe iniciativave të bashkive janë realizuar fushata ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi, sinjalistika informuese në kuadër të promovimit të mbarështimit dhe ruajtjes së pyjeve.

- **Realizimi 2024:** 70%

Masa 1.4.1 “*Fuqizimi i strukturave të turizmit vendor në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor* “. Në përgjithësi, zbatimi i masës për mbështetjen e strukturave të turizmit vendor nga bashkitë është i pjesshëm dhe i ndryshëm në nivel vendi, ku konstatohet një vëmendje e shtuar veçanërisht në bashkitë me volum të lartë të numrit të turistëve nga këto 20 bashki kanë raportuar ndërhyrje konkrete dhe përfshirje të strukturave të turizmit në aktivitete mbështetëse, ndërsa një pjesë tjetër nuk ka raportuar ose nuk ka struktura të turizmit të organizuara.

- **Realizimi 2023:** 25% | **Realizimi 2024:** 50%
- **Progres +25 pp** – vihet re një rritje e mbështetjes ndaj strukturave të turizmit vendor

Masa 1.4.2 “*Rishikimi i kuadrit ligjor mbi Trashëgiminë Kulturore*”. Në këtë kuadër, janë miratuar disa vendime të Këshillit të Ministrave që përcaktojnë zonifikimin, ruajtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike dhe qendrave historike në vend, konkretisht:

- Vendimi nr. 730, datë 13.12.2023, “Për miratimin e zonifikimit të zonave arkeologjike ‘A’ dhe ‘B’ të qytetit të Sarandës dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”;
- Vendimi nr. 637, datë 15.11.2023, “Për miratimin e zonës arkeologjike ‘A’ të Gradishtës së Selcës dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”;
- Vendimi nr. 764, datë 20.12.2023, “Për deklarimin e Qendrës Historike të një zone në qytetin e Gjirokastrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”;


- Vendimi nr. 827, datë 28.12.2023, “Për deklarimin e Qendrës Historike të një zone në qytetin-muze të Beratit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”;
- Vendimi nr. 831, datë 28.12.2023, “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Zonës Arkeologjike ‘A’ dhe ‘B’ të qytetit të Durrësit 2021–2028”.

- **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 40%
- **Progres +10 pp** - duke reflektuar progres të vazhdueshëm në konsolidimin e kuadrit ligjor dhe zbatimin e politikave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare.

Masa 1.4.3 “Ngritja e një sistemi/databazë të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor” ka vijuar gjatë vitit 2024 me funksionalizimin e aplikacionit TEA, i cili mundëson ngritjen e sistemit për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave mbi trashëgiminë kulturore në nivel vendor. Aktualisht, të dhënat mbi zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore janë ende në proces plotësimi, çka tregon se sistemi është në fazën e parë të implementimit dhe pasurimit të bazës së informacionit.

- **Realizimi 2023:** 20% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +80 pp** - procesi ka vijuar me funksionalizimin e aplikacionit TEA për ngritjen e sistemit të të dhënave mbi trashëgiminë kulturore

Qëllimi Politik 1



Grafiku: Niveli i realizimit të masave të QP1 nga viti 2023 në 2024

Duke krahasuar realizimin e masave për vitin 2024 me vitin 2023, vërejmë një rritje të numrit të masave që kanë realizim të plotë (100%), përkatësisht 10 masa nga 7 që ishin një vit më parë. Gjithashtu, duke qenë se ka rënë numri i masave në proces realizimi nga 9 në 7, këto masa që kanë patur ecuri pozitive janë realizuar plotësisht gjatë vitit 2024.


Një nivel të qëndrueshëm paraqesin masat që ndodhen në intervalin 6%–50%. Ndërkohë, vërejmë se masat që ndodhen në stadin 0%–5%, shënojnë një rritje krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje mund të jetë pasojë e ndalimit ose ngadalësimit të ecurisë pozitive të këtyre masave.

4.2 QP2: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardit të ofrimit të tyre për qytetarët


Statusi i zbatimit të qëllimit të dytë politik të agjendës së strategjisë, është realizuar në **masën 79%**. Në figurën 8 paraqiten katër objektivat specifike për QP.2, me masat përkatëse të detajuara në numër dhe përqindje realizimi total për çdo masë që ka objektivi specifik. Realizimi mund të cilësohet shumë i mirë në nxjerrje të produkteve të këtij qëllimi duke shënuar dhe Qëllimin Politik me realizimin më të lartë.

Objektivi Specifik	2.1	2.2	2.3	2.4
E pa gjurmuar	0	0	0	0
Pa filluar	0	1	2	0
Me vonesë	0	9	2	0
Në kohë	0	19	5	0
Përfunduar	4	21	0	3
Gabim	0	0	0	0
Realizimi në Përqindje (%)	100%	74%	42%	100%
Statusi i Objektivit	Shumë mirë	Shumë mirë	Mirë	Shumë mirë

Statusi i zbatimit të katër objektiveve specifike në QP2



Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP2



Zbatueshmëria e masave të QP2

Masa 2.1.1 “Vlerësim/Studim mbi efikasitetin e ofrimit të shërbimeve të ushtruara nga bashkitë” Gjatë vitit 2024 është finalizuar Raporti i Performancës së Bashkive për vitin 2023,

i cili vlerëson efikasitetin e shërbimeve, menaxhimin financiar, burimet njerëzore, qeverisjen dhe transparencën në 61 bashki, bazuar në 40 tregues të Sistemit të Matjes së Performancës (SMP). Raporti përmban analiza krahasuese dhe rekomandime për përmirësimin e politikave vendore.

- **Realizimi 2023:** 25% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +75 pp** - finalizuar Raporti Kombëtar i Performancës së Bashkive.

Masa 2.1.4 “Përgatitja e manualeve, rregulloreve, modeleve, planeve të përmirësimit të shërbimit (të përzgjedhura) që i shërbejnë organizimit të brendshëm të NJVV për një ofrim sipas standardeve të shërbimeve” Në periudhën shtator-tetor 2024 AMVV, në bashkëpunim me MSHPV-në, kanë hartuar Manualët Orientuese “Për implementimin e strukturave dhe organikave në njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Manualët janë hartuar sipas grupimit që i përket secila bashki në varësi të numrit të popullsisë. Qëllimi themelor është përmirësimi i efektivitetit të qeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve publike, duke integruar bashkërisht një sërë hapash konkretë në avancimin e mëtejshëm të kësaj iniciative të përbashkët. Manualët qartësojnë funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke kryer një ndarje ndërmjet strukturave, të cilat hartojnë politika dhe strukturave që i zbatojnë ato. Në këto materiale shpjegohet organizimi i strukturave në mënyrë të përgjithshme, duke bërë një përshkrim të shkurtër të detyrave funksionale dhe përgjegjësi ligjore. Gjithashtu janë hartuar “Manualët orientuese për strukturat organizative të bashkive. Modele orientuese për bashkitë për hartimin e Planeve të Integritetit, mbështetur në metodologjinë e hartimit të planeve të integritetit”.

- **Realizimi 2023:** 0% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +100 pp** - me përfundimin e manualeve orientuese, modeleve për planet e integritetit

Masa 2.2.2 “Hartimi i planeve 5-vjeçare të biznesit për të gjitha ndërmarrjet rajonale UKN sh. a, në konsultim me NJVV-të” Plane biznesi 5-vjeçar për 15 ndërmarrjet rajonale UKN sh.a.

- **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 80%
- **Progres +50 pp** – reflekton përmbylljen e fazës së përgatitjes dhe kalimin drejt miratimit dhe zbatimit të planeve të biznesit për ndërmarrjet rajonale UKN sh. a.

Masa 2.2.3 “Asistencë teknike për NJVV-të për rishikimin e tarifave të ujit të përdorur, në kuadër të reformës së rajonalizmit të UKN sh. a.”. Gjatë vitit 2023 reth 20% bashki me tarifa të miratuara në ERRU, ndërkohë që në vitin 2024: 70% bashki me tarifa të miratuara.

- **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 70%
- **Progres +40 pp** - progres i dukshëm në zbatim, por ka ende hapësira të mbetura në 18 bashki.

Masa 2.2.4 “Hartimi i kuadrit rregullator për përcaktimin e kritereve dhe rregullimi i mbrojtjes së burimeve ujore të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm” VKM nr. 379,

datë 25.05.2016, e ndryshuar me VKM nr. 403, datë 19.06.2024, do të përditësohet nga AMBU brenda vitit 2025, në kuadër të traspozimit të Direktivës së rishikuar të Bashkimit European për ujin (Direktiva 2020/2184). Ky përditësim do të realizohet në kuadër të projektit “EU4Rivers”, që zbatohet nga AMBU me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.

- **Realizimi 2023:** 25% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +65 pp** – gjatë vitit 2024 është shënuar një avancim i dukshëm në procesin e përditësimit të kuadrit rregullator për mbrojtjen e burimeve ujore të destinuara për prodhimin e ujit të pijshëm.

Masa 2.2.5 *“Rishikimin e kuadrit rregullator për arsimin me qëllim përfshirjen e vetëqeverisjes vendore në të gjitha proceset e arsimit parashkollor, përmes një procesi gjithëpërfshirës.”* Me qëllim garantimin e cilësisë, aksesit dhe funksionimit efektiv të arsimit parashkollor, Ministria e Arsimit (MA) mbështet rishikimin e kuadrit ligjor, duke mundësuar përfshirjen aktive të njërive të vetëqeverisjes vendore në të gjitha proceset nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse, që garanton konsultim me aktorët kryesorë: institucione qendrore, bashki, profesionistë të fushës, prindër dhe partnerë zhvillimi. Qëllimi është krijimi i një modeli funksional dhe të integruar të arsimit parashkollor, ku roli i vetëqeverisjes vendore fuqizohet si garantues i aksesit dhe i cilësisë së shërbimit në nivel lokal që lidhet kryesisht me:

- Planifikimin e rrjetit të institucioneve parashkollore sipas nevojave të komunitetit;
- Administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore;
- Sigurimin e financimit të qëndrueshëm për shërbimet e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme;
- Përfshirjen e komunitetit dhe prindërve në vendimmarrje dhe në proceset e edukimit të hershëm.
- Monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve, në bashkëpunim me strukturat qendrore;

Për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve MA ka miratuar:

- “Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshtit”, që është një dokument i rëndësishëm, në funksion të përmbushjes së detyrave të institucioneve që monitorojnë dhe vlerësojnë cilësinë e shërbimeve që ofron kopshti, drejtuesve të kopshteve dhe politikëbërësve, për hartimin e politikave më të mira në këtë fushë.
- Ky dokument u shërben edhe prindërve, për të njohur më mirë shërbimet dhe detyrimet që ka kopshti ndaj fëmijëve të tyre, si dhe për të qenë pjesëmarrës më aktivë në jetën dhe në veprimtarinë e kopshtit nëpërmjet kontributit të tyre.

Gjithashtu MA ka miratuar:

- “Udhëzuesin metodologjik për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit”, i cili përmban gjithë protokollin, procedurat, instrumentet dhe dokumentacionin e plotë për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit.

Vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm i kopshtit kryhet sipas një metodologjie shkencore, të qartë, të besueshme dhe bashkëkohore, e cila siguron të dhëna reale dhe ofron mundësi për të evidentuar pikat e forta dhe të dobëta, mundësitë që ka kopshti për të ofruar shërbim arsimor cilësor dhe, në mënyrë të veçantë, nevojat për përmirësimin e tij në të ardhmen.

- Vlerësimi i brendshëm ka për synim të drejtojë e të orientojë kopshtet për mënyrën se si do ta realizojnë vlerësimin në mënyrë objektive. Në këtë proces angazhohen të gjithë aktorët që ofrojnë dhe marrin shërbim si drejtuesi i kopshtit, mësuesit, stafi mbështetës, psikologu/punonjësi social, prindërit, fëmijët dhe anëtarë të komunitetit.
- **Realizimi 2023: 40% | Realizimi 2024: 80%**
- **Progres +40 pp** - masa është avancuar me finalizimin e dokumenteve rregullatore, miratimin e kornizës dhe udhëzuesit metodologjik, si dhe përfshirjen aktive të bashkive në proceset e planifikimit dhe vlerësimit të arsimit parashkollor.

Masa 2.2.6 “*Avancimi i decentralizimit të funksionit të arsimit parashkollor duke i dhënë kompetenca bashkive a) hartimin e politikave nga qeverisja vendore, b) të përshtatin funksionin me rrethanat vendore dhe c) të përfshijë aktorët lokalë (si këshillat e prindërve) në procesin e vendimmarrjes*” Ministria e Arsimit bashkëpunon me AMVV dhe me Bashkitë për të avancuar procesin e decentralizimit të funksionit të arsimit parashkollor që lidhet me:

- Kuadri ligjor dhe institucional;
- Financimi i qëndrueshëm;
- Cilësia dhe standardet;
- Përfshirja dhe llogaridhënia;
- Inovacioni dhe digjitalizimi.

Në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 81, datë 15.5.2024 “Për ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës për hartimin e mekanizmit pilot “decentralizim horizontal”, që lidhet me ushtrimin e funksioneve të përbashkëta në fushën e arsimit, midis pushtetit qendror dhe vendor, MA më 22.10.2024, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me bashkitë Divjakë, Shkodër dhe Kolonjë për të zbatuar projektin pilot të përfshirjes së bashkive në ushtrimin e përgjegjësi në fushën e arsimit parauniversitar për institucionet arsimore parauniversitare që janë në territorin e tyre.

Pilotimi i ushtrimit të përgjegjësi nga bashkitë në fushën e arsimit parauniversitar shënon një hap të rëndësishëm në avancimin e decentralizimit të funksioneve të arsimit për të gjitha nivelet e sistemit parauniversitar.

- **Realizimi 2023: 30% | Realizimi 2024: 70%**
- **Progresi: +40 pp** - pilotim praktik në 3 bashki dhe nënshkrim marrëveshjes.

Masa 2.2.8 “*Përcaktimin e skemës së kompensimit financiar dhe mbulimit të shpenzimeve të transportit për nxënësit që ndjekin procesin mësimor në institucionet e arsimit parashkollor publike, jashtë vendbanimit*”. Bazuar në VKM nr.119, datë 01.03.2023, “Për përdorimin e

fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar, të gjithë nxënësve të arsimit parashkollor që udhëtojnë nga adresa e vendbanimit të përhershëm mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (kopshteve) dhe në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës, i mbulohen shpenzimet e transportit.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.9 “*Rritja e rolit të pjesëmarrjes së prindërve në edukimin parashkollor përmes fuqizimit të bordeve dhe fushatave të dedikuara informuese*”. Në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të çdo forme dhune dhe bullizmi për sigurinë në institucionet arsimore parauniversitare, miratuar me Urdhrin nr. 32, datë 21.01.2025, është parashikuar që përmes fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere, të organizuara nga institucionet arsimore parauniversitare, të rritet ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit, si dhe të forcohet roli i Këshillit të Prindërve.

Ndërkohë, në Urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është fuqizuar më tej roli i prindërve përmes përfshirjes aktive të Këshillit të Prindërve në proceset e vlerësimit dhe vendimmarrjes në institucionet arsimore. Konkretisht, në nenin 46 përcaktohet se vlerësimi i drejtorit bazohet, ndër të tjera, edhe në vlerësimin vjetor të Këshillit të Prindërve përmes një pyetësori standard në SMIP, i cili plotësohet në mënyrë digjitale nga anëtarët e këshillit çdo muaj korrik të vitit korrent.

Gjithashtu, në nenin 89 të rregullores është parashikuar që Këshilli i Prindërve të institucionit arsimor ka të drejtë të thërrasë mbledhjen e përgjithshme të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, duke forcuar kështu rolin e tyre në proceset e konsultimit dhe bashkëpunimit me institucionet arsimore, për garantimin e një mjedisi më të sigurt dhe mbrojtës për nxënësit në të gjitha nivelet, përfshirë edhe institucionet parashkollore.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.11 “*Asistencë teknike dhe financiare për NJVV për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve, përfshirë mbledhjen e të dhënave (procedurat standarde të veprimit në arsimin parashkollor, vlerësimi i performancës së drejtorëve të kopshtit, planet e përmimirësimit të shërbimit, etj)*”. Ministria e Arsimit nëpërmjet ASCAP do të punojë për hartimin e dokumentit për “Vlerësimin e performancës së drejtorëve të kopshtit”, bazuar në 2 dokumentet e miratuara nga MA: Standardet profesionale të drejtuesve të kopshteve dhe Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit. Në lidhje me asistencën teknike për planet e përmimirësimit të shërbimit, të cilat hartohen nga bashkitë, si dhe për procedurat standarde të veprimit në arsimin parashkollor, nuk është kërkuar asistencë teknike.

➤ **Realizimi 2023:** 25% | **Realizimi 2024:** 50%

➤ **Progres +25 pp** – është në proces hartimi dokumenti “Vlerësimi i performancës së drejtorëve të kopshtit” nga ASCAP, bazuar në standardet profesionale të drejtuesve dhe Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshtit.

Masa 2.2.14 *“Rishikimi i kompetencës bashkiake për monitorim dhe sanksione administrative direkte lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe kompetencës vendore në fushën e mbrojtjes nga ndotja e ajrit, ujit dhe akustike”*. Hartimi i 35 vendimeve TIP të Këshillit Bashkiak, 4 urdhrave TIP të Kryetarit të Bashkisë dhe 6 draft-rregulloreve për bashkitë, të cilat mbulojnë çështje të ndryshme të funksionimit të tyre. Këto modele do të shërbejnë si dokumente referuese dhe praktike për bashkitë. Gjatë vitit 2024 janë hartuar 35 vendime TIP të Këshillave Bashkiakë, 4 urdhra TIP të kryetarëve të bashkive dhe 6 draft-rregullore që mbulojnë fusha të ndryshme të funksionimit të bashkive. Këto dokumente synojnë të shërbejnë si modele referuese për përdorim praktik nga njësitë vendore.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.17 *“Vlerësim strategjik të mjedisit të secilës bashki (identifikim i problemeve mjedisore, përditësim i zonave të ndjeshme ku ndodhen ndërtesat me kërkesa të veçanta për nivelin e zhurmave, përcaktim i objektivave vendore të mjedisit për secilën bashki, etj)”*. Shumica e bashkive nuk kanë përfunduar identifikimin e problemeve mjedisore, përcaktimin e objektivave vendore dhe hartimin e vlerësimit strategjik të mjedisit, ndërsa vetëm 16 bashki kanë të miratuar një dokument vlerësimi strategjik të mjedisit.

➤ **Realizimi 2023:** 31% | **Realizimi 2024:** 45%

➤ **Progres +14 pp** – një pjesë e bashkive nuk kanë raportuar për këtë masë ose kanë raportuar vetëm problemet mjedisore. Vlerësim strategjik të mjedisit kanë miratuar vetëm 16 bashki për vitin 2024.

Masa 2.2.18 *“Nisma për edukimin ambientel të komunitetit (rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim, hedhjen e tyre me orar si edhe përdorimi i çantave ekologjike të riciklueshme, të cilat përmirësojnë dhe mbrojnë mjedisin urban)”*. Bashkitë kanë organizuar aktivitete ndërgjegjëse me qytetarët dhe shkollat në kuadër të edukimit ambientel të komunitetit.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.19 *“Studimi për përcaktimin e zonave të mbetjeve dhe modelit institucional të qeverisjes dhe organizimit të Zonave të Mbetjeve dhe rolin e NJVV-ve”* Është parashikuar në projektligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili është dërguar për miratim në parlament. Gjithashtu, gjatë vitit 2023 janë përgatitur propozimet për infrastrukturën rajonale të mbetjeve për Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug - Gjirokastrë dhe Zonën e Mbetjeve Kukës, të cilat janë prezantuar me bashkitë respektive për këto zona. Aktualisht janë në perfundim studimet për infrastrukturën rajonale të mbetjeve për zonat Vlorë Jug- Gjirokastrë dhe Kukës.

➤ **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 85%

➤ **Progres +35 pp** – gjatë vitit 2024 është arritur një avancim i ndjeshëm në zbatimin e masës.

Masa 2.2.20 “Studim dhe asistencë teknike për qartësimin dhe negocimin e marrëdhënieve kontraktuale të NJVV-ve me qeverinë qendrore dhe impiantet e trajtimit të mbetjeve përfshirë dhe rishikimin e kuadrit rregullator”. Bashkëpunimi ndërvendor është parashikuar në projektligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili është dërguar për miratim në parlament.

- **Realizimi 2023:** 0% | **Realizimi 2024:** 90%
- **Progres +90 pp** - masa është në proces realizimi dhe pritët miratimi në parlament.

Masa 2.2.22 “Hartimi i kuadrit rregullator për zbatueshmërinë e parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për bashkitë dhe qarqet”. Është hartuar projektligji “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”, i cili është miratuar në Këshill të Ministrave në Dhjetor 2023. Projektligji është dërguar për miratim në parlament në janar 2024.

- **Realizimi 2023:** 20% | **Realizimi 2024:** 90%
- **Progres +70 pp** – masa është në proces realizimi, pritët miratimi në parlament.

Masa 2.2.23 “Konceptimi dhe hartimi i masave nxitëse fiskale dhe financiare për aktivitetet ricikluese dhe kompostuese në nivel vendor”. Janë në proces finalizimi qendrat e kompostimit në 4 bashki Përmet, Gramsh, Shkodër dhe Lezhë. Gjithashtu, në bashkëpunim me bashkinë Berat dhe AKEM është ndërmarrë nisma “Berati riciklon” ku fokusi është në grumbullimin e diferencuar dhe riciklimin e mbetjeve.

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.24 “Fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për mobilizimin e komunitetit për ndarjen në burim dhe monitorimin e cilësisë së shërbimit”. Gjatë vitit 2023 është zhvilluar projekti “Miku i Mjedisit”. Projekti është zbatuar në 37 shkolla në Tiranë me synimin për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e riciklimit dhe të inkurajojë qytetarët, nxënësit, komunitetet dhe organizatat të ndërmarrin veprime për të reduktuar mbetjet dhe për të promovuar qëndrueshmërinë mjedisore.

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.25 “Ngritja e burimeve njerëzore në nivel teknik e menaxherial për menaxhimin e shërbimit të mbetjeve përmes një kurrikule dhe sistemi certifikimi të njehsuar”. Gjatë vitit 2023 është krijuar Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, e cila siguron koordinimin, monitorimin dhe bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e administratës publike dhe partnerët ndërkombëtarë në menaxhimin e integruar të mbetjeve.

- **Realizimi 2023:** 20% | **Realizimi 2024:** 50%

- **Progres +30 pp** - Masa ka shënuar një progres të konsiderueshëm gjatë vitit 2024, duke kaluar nga faza fillestare institucionale (20%) në një fazë funksionale dhe zhvillimore (50%).

Masa 2.2.26 *“Hartimin e raportit të vlerësimit për mbikëqyrjen e sigurisë së digave dhe rolin e NJVV-ve”*. Kjo masë zbatohet në bazë të VKM nr. 147, datë 18.3.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”. MBZHR dhe bashkitë, për digat përkatëse në pronësi të tyre, hartojnë dhe dorëzojnë pranë KKDM-së, në muajin mars, Raportin e monitorimit të sigurisë së digave.

Për këtë proces, MBZHR ka mbështetur aktivitetin e bashkive me dy akte nënligjore:

- Udhëzimi nr. 12, datë 30.12.2019, “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”;
- Urdhri nr. 697, datë 30.12.2019, “Për miratimin e regjistrave të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit”.

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.27 *“Harmonizimi i kuadrit rregullator për menaxhimin e burimeve ujore vendore”* Për këtë masë janë raportuar shpenzime korrente të kryera për zbatimin e saj me fonde nga financues të tjerë. Sipas sqarimeve të dhëna nga institucioni përgjegjës, vlera totale në euro (439,176) i referohet komponentit “Legal Framework”, i cili përfshinte një paketë të plotë ligjore dhe jo vetëm hartimin dhe miratimin e një ligji të vetëm. Kjo paketë përfshinte, ndër të tjera, edhe ligjin “Për Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë”, si dhe një sërë VKM-sh të tjera që janë aktualisht në proces hartimi

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.29 *“Hartimi dhe miratimi i projekteve për ndërtimin dhe funksionimin e terminaleve të udhëtarëve dhe autobuseve të shërbimit të transportit publik vendor”*. Për këtë masë 34 bashki kanë terminale të autobusave ndërqytetas, si dhe nuk është raportuar për vitin 2024 projekte të hartuara në kuadër të terminaleve për transportin publik duke e mbajtur këtë masë në nivel të qëndrueshëm.

- **Realizimi 2023:** 40% | **Realizimi 2024:** 40%
- **Nivel i qëndrueshëm**, masa nuk ka shënuar progres dhe mbetet në të njëjtin nivel si viti i kaluar.

Masa 2.2.30 *“Miratimi nga bashkitë i politikave dhe nxitësve financiarë vendorë për autobusët urbanë elektrike dhe taksitë ekologjike/elektrike”*. Bashkia Tiranë dhe Durrës kanë politika për përdorimin e makinave elektrike për taksi dhe urbanë. Nga bashki të tjera nuk raportohet të ketë politika nxitëse të miratuara,

- **Realizimi 2024:** 50%

Masa 2.2.31 “Zhvillimi i mekanizmave rregullatorë dhe financiarë për të nxitur bashkëpunimet ndërvendore për transportin publik vendor dhe lëvizshmërinë aktive”

- Ligji nr. 84/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2019, për projektin “transport i qëndrueshëm në Tiranë (DKTI)”
- VKM nr. 661, datë 27.8.2020 “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2019 për projektin “për një transport publik udhëtarësh miqësor me mjedisin në Metropolin e Tiranës (DKTI)”

➤ **Realizimi 2024:** 50%

Masa 2.2.32 “Studimi për mekanizmin e Fondit Social dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel bashkie/qarku si edhe gjithë aktorëve në përdorimin efektiv të Fondit Social” Realizuar një document politikash nga MSHMS, në bashkëpunim me ekipin teknik të AT EU4SI, rekomandimet u reflektuan në rishikimin e VKM-së 224, datë 09.04.2024 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.33 “Plotësimi i kuadrit rregullator për prokurimin e shërbimeve sociale (manual dhe udhëzues) dhe bashkëpunimin me aktorë publikë e private” MSHMS ka hartuar Manualin e Prokurimit për shërbimet sociale, i cili qartëson hapat që njësitë e qeverisjes vendore duhet të ndjekin për të kontraktuar shërbime në përputhje me kuadrin rregullator të Fondit Social.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.34 “Mbështetja për fuqizimin e NJVNR-ve për menaxhimin e rasteve në mënyrë graduale në të gjitha njësitë vendore” Nga 61 bashki, 29 kanë ngritur departamente të posaçme për shërbimet sociale, ndërsa pjesa tjetër funksionon përmes sektorëve socialë. Strukturat e NJVNR-ve janë ngritur në 19 bashki.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.35 “Rritje kapacitetesh për stafet vendore për menaxhimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve, përfshirë nënkontraktimin e kujdesit social bazuar në modele, sigurimin e cilësisë dhe inspektimin” Numri i personelit në njësitë e pushtetit vendor, drejtoritë rajonale dhe niveli qëndror i trajnuar për planifikimin, financimin, prokurimin dhe përgjigjen ndaj krizave për periudhën maj 2024 qershor 2025 është 314.

➤ **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 100%

➤ **Progres +50 pp** - i arritur falë rritjes së ndjeshme të numrit të stafit vendor dhe institucional të trajnuar gjatë vitit 2024, duke plotësuar plotësisht objektivin e ngritjes së kapaciteteve.

Masa 2.2.36 “Identifikimi dhe planifikimi i shërbimeve të nevojshme në nivel bashkie e qarku për gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit dhe PAK (shërbime të specializuara)”. Harta e

Shërbimeve Sociale 2025, e hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), paraqet një panoramë të plotë dhe të përditësuar të shërbimeve sociale që ofrohen në nivel kombëtar dhe vendor. Harta e Shërbimeve Sociale 2025 shërben si një instrument orientues për planifikimin dhe shpërndarjen më të drejtë të burimeve, duke mbështetur procesin e de-institucionalizimit dhe zhvillimin e kujdesit alternativ në Shqipëri.

Nga të dhënat rezulton se 44% e përfituesve të shërbimeve marrin shërbime komunitare për të gjithë individët dhe familjet në nevojë, ndërsa në shërbimet e specializuara grupet e përfituesve ndahen si vijon: fëmijë me aftësi të kufizuara (10%), të moshuar (15%), viktimat të dhunës në familje/trafikimit (6%), të rritur me aftësi të kufizuara (6%), fëmijë pa kujdes prindëror (3%), komuniteti Rom dhe Egjiptian (9%) dhe të rinj (7%).

- **Realizimi 2023:** 80% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +20 pp** – paraqet një progres prej 20% duke finalizuar realizimin e masës.

Masa 2.2.37 “*Ngritja e shërbimeve të specializuara në mbështetje të reformës PAK dhe përmirësimi i aksesit fizik në këto shërbime, shoqëruar me paketën për referim dhe ofrim të rehabilitimit, si edhe riaftësimin e tyre*”. Në kuadër të Fondit Social 2024, është ofruar mbështetje financiare për ngritjen dhe funksionimin e 29 shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë 10 shërbime të reja (8 shërbime lëvizëse dhe 2 shërbime komunitare) në 22 bashki dhe 4 qarqe.

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.39 “*Ngritje e kapaciteteve për stafet vendore për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe protokollet përkatëse, koordinim me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve*”. Lidhur me këtë masë janë trajtuar 32 raste të të miturve të mbikëqyrur nga QPKM; ndërkohë që 151 përfaqësues të institucioneve të ndryshme kanë marrë pjesë në trajnime dhe sesione informuese në disa bashki.

- **Realizimi 2023:** 33% | **Realizimi 2024:** 80%
- **Progres +47 pp** – gjatë vitit 2024 është arritur një rritje e dukshme e nivelit të zbatimit të masës.

Masa 2.2.40 “*Ngritja dhe përdorimi i sistemit të mbledhjes sistematike të të dhënave në lidhje me strehimin social në disa bashki pilot*”. Sistemi i strehimit social aktualisht është funksional dhe kanë hedhur të dhëna 56 bashki, ndërsa 4 bashki të tjera kanë hapur user-at në sistem, por ende nuk kanë hedhur të dhëna. Bashkitë të cilat kanë hedhur të dhëna mbi aplikimet për programet e strehimit kanë shqyrtuar një pjesë të dokumentacionit të aplikimeve online.

- **Realizimi 2023:** 20% | **Realizimi 2024:** 70%
- **Progres +50 pp** – gjatë vitit 2024 është arritur një rritje e dukshme e nivelit të zbatimit të masës.

Masa 2.2.42 “*Identifikimi dhe hartëzimi i proceseve në të gjitha nivelet e strukturave të DPMZSH-së me qëllim propozimin e sistemeve inovative për lehtësimin e procesve të punës, monitorimin në kohë reale dhe ofrimin e shërbimeve online për qytetarët*”. Në lidhje me këtë

masë, nuk është evidentuar ndonjë avancim i mëtejshëm në realizimin e saj gjatë vitit 2024, pasi raportimi nga DMZSH mbetet i njëjtë me atë të vitit 2023.

- **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 50%
- **Niveli i zbatimit** - nuk ka progres të ri gjatë vitit 2024, pra masa nuk ka pësuar ndryshim në nivel realizimi krahasuar me vitin e kaluar.

Masa 2.2.43 “*Identifikimi i projekteve që do të mundësonin digjitalizimin e shërbimit të DPMZSH-së lidhur me thirrjet e adresuara te numri unik 128*”. Lidhur me këtë masë nuk ka patur ndonjë zhvillim pasi nuk është miratuar ende ligji i ri për mbrojtjen nga zjarri dhe udhëzimeve përkatëse. Përgatitja e draftit final të ligjit dhe miratimi i tij do ti hapë rrugën implementimit të projekteve për digjitalizimin e shërbimit të DPMZSH-së.

- **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 50%
- **Niveli i zbatimit** - nuk ka progres të ri gjatë vitit 2024, pra masa nuk ka pësuar ndryshim në nivel realizimi krahasuar me vitin e kaluar.

Masa 2.2.44 “Hartimi i dokumenteve të strategjisë për zvogëlimin dhe vlerësimin e riskut në nivel vendor (plani kombëtar i emergjencave civile dhe plani operacional)”. Lidhur me dokumentet e miratuara deri në vitin 2024, Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë është miratuar nga bashkitë:

- Mallakastër (VKB nr.19, datë 26.04.2023), Divjakë (nr.21, 28.04.2023), Roskovec (nr.45, 27.04.2023), Gramsh (nr.89, 31.10.2022), Fier (nr.54, 17.05.2023), Lushnje (nr.49, 30.06.2023), Patos (nr.38, 30.06.2023), Kolonjë (nr.113, 30.10.2023), Korçë (nr.93, 26.06.2024) dhe Gjirokastrë (nr.80, 05.12.2024).

Strategjia për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është miratuar nga bashkitë:

- Fier (VKB nr.123, datë 31.10.2024), Divjakë (nr.61, 25.11.2024), Gjirokastrë (nr.81, 05.12.2024) dhe Patos (nr.91, 19.12.2024).

Plani për Emergjencat Civile është miratuar nga

- Bashkia Peqin (VKB nr.41, datë 27.09.2024) dhe Kolonjë (nr.101, 30.10.2024).
- **Realizimi 2023:** 35% | **Realizimi 2024:** 18%
- **Regres -17 pp** – pasi megjithëse një numër bashkish kanë miratuar dokumente të rëndësishme strategjike gjatë vitit 2024, ritmi i miratimeve ka qenë më i ulët krahasuar me vitin paraardhës.

Masa 2.2.45 “*Hartimi i planit vendor për emergjencat civile*”. Për vitin 2024 nga 44 raportime të bashkive rezultojnë të kenë një plan emergjencash civile të miratuar në KB 17 bashki: Elbasan, Fier, Finiq, Mallakastër, Gjirokastrë, Gramsh, Klos, Maliq, Polican, Tirana, Kolonjë, Kucovë, Pogradec, Librazhd, Mat, Përmet, Shijak. Gjatë vitit 2024 janë menaxhuar në total 1,158 raste emergjencash civile nga bashkitë, të kategorizuara kryesisht në raste zjarresh, duke vijuar me rastet e përmbytjeve, raste rrëshqitje dherash, bllokim rrugësh nga dëbora.

- **Realizimi 2023:** 48% | **Realizimi 2024:** 70%
- **Progres +22 pp** – për këtë masë 17 bashki rezultojnë të kenë hartuar një plan për emergjencat civile.

Masa 2.2.46 “*Krijimi i bazës së të dhënave në nivel vendor për emergjencat civile*”. Sipas raportimeve nga NJVV-të rezultojnë të kenë 19 bashki një regjistër të dhenash për emergjencat civile: Elbasan, Fier, Mallakastër, Devoll, Dimal, Durrës, Gjirokastrë, Gramsh, Maliq, Poliçan, Tiranë, Kolonjë, Kuçovë, Lezhë, Pogradec, Librazhd, Delvinë, Mat, Përmet.

- **Realizimi 2023:** 67% | **Realizimi 2024:** 70%
- **Progres +3% pp** – Masa nuk ka pësuar zbatim të plotë pasi shumica e bashkive nuk e kanë raportuar, ndërsa vetëm 19 prej tyre kanë raportuar të kenë një regjistër të dhenash rreth emergjencave civile.

Masa 2.2.47 “*Forcimi i strukturës vendore për mbrojtjen civile*”. Sipas raportimeve të NJVV-ve për vitin 2024, vërehet një stabilitet në strukturën e disa bashkive që nuk kanë regjistruar rritje, ndërsa nga ana tjetër, 10 bashki kanë shënuar rritje të kapaciteteve përmes shtimit të numrit të punonjësve.

- **Realizimi 2023:** 26% | **Realizimi 2024:** 40%
- **Progres +14 pp** – Vërehet një rritje e pjesshme e numrit të punonjësve në strukturat e mbrojtjes civile.

Masa 2.2.48 “*Trajnimi i punonjësve të NJVV dhe grupeve vullnetare komunitare për përballimin e situatave të fatkeqësive natyrore*”. Për vitin e raportimit 2023 aktivitetet ishin të lokalizuara dhe me shtrirje të pjesshme, kryesisht në nivel bashkie. Ndërsa për vitin e raportimit 2024 është raportuar se në total, janë përfshirë rreth 500 pjesëmarrës në aktivitete trajnimi dhe stërvitjeje, me përhapje kombëtare dhe karakter teknik të avancuar. Në krahasim me vitin e kaluar, progresi është i qartë dhe i shumëanshëm. Janë rritur shtrirja territoriale, numri i pjesëmarrësve, niveli teknik i trajnimeve, si dhe përfshirja institucionale dhe ndërkombëtare. Nëse në vitin 2023 aktivitetet ishin të kufizuara në dy bashki me pak pjesëmarrës, në vitin 2024 është arritur zgjerim kombëtar dhe cilësim profesional i procesit të trajnimit. Në gjashtëmuorin e dytë, u organizua një trajnim specifik mbi përdorimin e bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë, me 36 pjesëmarrës.

- **Realizimi 2023:** 70% | **Realizimi 2024:** 70%
- **Niveli i zbatimit** - nuk ka progres të ri gjatë vitit 2024, pra masa nuk ka pësuar ndryshim në nivel realizimi krahasuar me vitin e kaluar.

Masa 2.2.49 “*Hartimi i akteve nënligjore për Policinë Bashkiake*”. Për këtë masë kemi:

- VKM nr. 452, datë 26.7.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”;

- VKM nr. 494, datë 24.8.2023 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.2.50 “*Plotësimi i kuadrit rregullator të funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike*”. VKM nr. 678, datë 30.10.2024, “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet”

- **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +50 pp** – gjatë vitit 2024 është finalizuar plotësisht masa me miratimin e VKM nr. 678, datë 30.10.2024

Masa 2.2.51 “*Nxitja për forcimin e kapaciteteve administrative dhe trajnimi i punonjësve të policisë bashkiake*”. 1- Ligji nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, përcakton se: Neni 8 “Përgjegjësitë dhe detyrat e kryetarit të bashkisë” d) miraton kalendarin e trajnimeve të punonjësve të Policisë Bashkiake.

- **Realizimi 2023:** 70% | **Realizimi 2024:** 75%
- **Progres +5 pp** - i reflektuar nga rritja e lehtë në miratimin dhe zbatimin e kalendarëve të trajnimit nga bashkitë, duke përmirësuar pjesërisht kapacitetet administrative dhe përgatitjen e Policisë Bashkiake sipas kërkesave të ligjit nr. 89/2022.

Masa 2.3.4 “*Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimit të arsimit parashkollor dhe kostimi i tyre*” Për vitin e raportimit 2023 tregohet një progres i dukshëm në nivelin e përgatitjes teknike dhe normative, me fokus në cilësinë e procesit edukativ dhe profesionalizimin e stafit arsimor. Megjithatë, nuk kishte ende informacion për miratimin e plotë të standardeve të shërbimit apo kostimin e tyre, pra masa ishte në zhvillim, jo e përfunduar. Ndërsa për vitin e raportimit 2024 procesi i hartimit të standardeve pedagogjike është përmbyllur, por komponenti i standardeve të shërbimit dhe kostimit nuk është avancuar dhe nuk ka progres të ri institucional nga viti i kaluar.

- **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 65%
- **Progres +35 pp** – gjatë vitit 2024 është shënuar përparim i dukshëm në përfundimin e procesit të hartimit të standardeve pedagogjike për arsimin parashkollor

Masa 2.3.7 “*Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimit të mbetjeve dhe kostimi i tyre*”. Lidhur me këtë masë është miratuar treguesi i performancës së bashkive: një dekadë transformimi nga reforma administrativo – territorial.

- **Realizimi 2023:** 20% | **Realizimi 2024:** 70%

- **Progres +50 pp** – gjatë vitit 2024 është arritur një përparim i konsiderueshëm me miratimin e treguesit të performancës së bashkive.

Masa 2.3.8 “*Studim fizibiliteti për standardet minimale kombëtare për ofrimin e shërbimeve të transportit publik vendor dhe politikat sociale (tarifat e lehtësuara)*”. Harmonizimi i kuadrit rregullator për transportet rrugore: Përmblusur me miratimin e Udhëzimit Nr. 16, datë 20.12.2023, “Për shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve”, në përfaqsim me Rregulloren (KE) nr. 1370/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23.10.2007. Ndërkohë duhet të theksohet se, në mënyrë të veçantë, përcaktimi i tarifave të lehtësuara për transportin urban është kompetencë e bashkive, pasi miratohen me VKB.

- **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 60%
- **Progres +30 pp** – gjatë vitit 2024 është shënuar një avancim i konsiderueshëm me miratimin e Udhëzimit nr. 16, datë 20.12.2023.

Masa 2.3.9 “*Hartimi dhe miratimi i standardeve për ndërtimin dhe funksionimin e stacioneve multimodale të mjeteve të transportit publik vendor*”. MIE shprehet se, bazuar në Udhëzimin nr. 446, datë 10.05.2018, “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimin, mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve”, përcaktohet se përgjegjësia për standardet dhe funksionimin e terminaleve u takon bashkive. Kjo është në përputhje me nenin 8 të udhëzimit, i cili parashikon kriteret e përgjithshme për autorizimin e njësisë së menaxhimit të terminalit.

- **Realizimi 2023:** 0% | **Realizimi 2024:** 0%
- Masa **nuk ka nisur** ende të zbatohet.

Masa 2.4.1 “*Ndërtimi i një sistemi bazuar mbi performancë mbështetur në tregues të matshëm e të verifikueshëm*”. Është finalizuar Sistemi Kombëtar i Matjes së Performancës, i ndërtuar mbi 40 tregues të matshëm dhe të verifikueshëm, me një platformë të dedikuar për raportim dhe analizë të të dhënave. Treguesit janë vlerësuar dhe miratuar nga Grupi Teknik i Punës dhe Grupi Ndërinstitucional i Punës, duke siguruar standardizimin e monitorimit të performancës së bashkive në nivel kombëtar.


- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 2.4.3 “*Hartimi i udhëzuesve për ngritjen e Njësive të Performancës në nivel bashkie dhe rritja e kapaciteteve për përdorimin e tij*”. Është finalizuar Udhëzuesi për krijimin dhe funksionimin e Njësive të Performancës në bashki, me qëllim standardizimin e strukturës dhe rolit të këtyre njësive në monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të performancës vendore. Dokumenti është hartuar në bashkëpunim me projektin “Bashki të Forta”, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe në forcimin e sistemit të matjes së performancës.

- **Realizimi 2023:** 99% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +1 pp** - finalizuar dhe miratuar udhëzuesi për funksionimin e Njësive të Performancës në bashki.

Duke krahasuar realizimin e masave për vitin 2024 me vitin 2023, vërejmë një rritje të numrit të masave që kanë realizim të plotë (100%), përkatësisht 27 masa krahasuar me 19 masa një vit më parë. Gjithashtu, numri i masave në proces realizimi është rritur me një masë, nga 18 në 19 masa. Një nivel të qëndrueshëm paraqesin masat që ndodhen në intervalin 6%–50%, të cilat janë 18 masa në vitin 2024, krahasuar me 24 masa në vitin 2023. Ndërkohë, vërejmë një ulje të numrit të masave që ndodhen në stadin 0%–5%, nga 5 masa në vitin 2023 në 2 masa në vitin 2024.

Qëllimi Politik 2




Niveli i realizimit të masave të QP2 nga viti 2023 në 2024

4.3 QP3: Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre


Statusi i zbatimit të qëllimit të tretë politik të agjendës së strategjisë, është realizuar në masën **53%**. Në figurën e mëposhtme paraqitet objektivi specifik për QP.5 me masat përkatëse të detajuar në numër dhe përqindje realizimi total për çdo masë që ka objektivi specifik. Realizimi i këtij qëllimi mund të cilësohet i mirë në realizueshmëri të produkteve në funksion të këtij qëllimi politik.

Objektivi Specifik	3.2
E pa gjurmuar	0
Pa filluar	0
Me vonesë	9
Në kohë	1
Përfunduar	1
Gabim	0
Realizimi në Përqindje (%)	53%
Statusi i Objektivit	Shumë mirë

Statusi i zbatimit të objektivit specifik në QP3



Statusi i zbatimit të objektivit specifik në QP3




Zbatueshmëria e masave të QP3

Për masat e QP3 kemi raportimin e mëposhtëm nga institucioni AKSHI ku shprehen si më poshtë për çështjet kryesore:

- Përfshirja në programin GovTech AF: Ky objektiv është pjesë e programit “Financimi shtesë për Veprimin e ofrimit të shërbimeve të përqendruara dhe gjithëpërfshirëse të përdoruesit (GovTech AF)”, i ratifikuar me ligjin nr. 45, datë 26/06/2025;
- Krijimi i Grupit të përbashkët të punës: Është ngritur Grupi i përbashkët i punës për Ri-inxhinierimin dhe Digjitalizimin e Shërbimeve Vendore, i cili ka miratuar;
- Akt Miratimi nr. 01, datë 26.12.2024, që përcakton listën e shërbimeve prioritare për digjitalizim;
- Periudha e zbatimit: Programi dhe masat do të zbatohen në periudhën 2025–2029;
- Koordinimi me Bankën Botërore: Në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore janë dakordësuar hapat vijues:
 - Ofrimi i asistencës teknike për analizën e nevojave të bashkive;
 - Hartimi i planit të fuqisë punëtore për ofrimin e shërbimeve dhe nevojat në fushën e TIK, i miratuar nga grupi i punës;
 - Deri në fund të vitit 2027 do të jenë digjitalizuar dhe integruar në e-Albania 2.0: 8 shërbime prioritare të qeverisjes vendore,
 - 2 shërbime të lidhura me ndryshimet klimatike.

Gjithashtu janë vendosur bazat institucionale dhe ligjore, është miratuar lista e shërbimeve prioritare dhe janë planifikuar masat teknike e njerëzore për digjitalizimin e shërbimeve vendore gjatë periudhës 2025–2029, me qëllim integrimin e tyre në platformën e-Albania 2.0.

Qëllimi Politik 3



Niveli i realizimit të masave të QP3 nga viti 2023 në 2024

Duke krahasuar realizimin e masave për vitin 2024 me vitin 2023, vërejmë një rritje të numrit të masave që nuk kanë nisur të realizohen, përkatësisht asnjë masë krahasuar me 6 masa të një viti më parë. Gjithashtu, numri i masave në proces realizimi është rritur me 4 masa, nga 4 në 8 masa në vitin 2024.


Gjithashtu shohim që masat që ndodhen në intervalin 51%–99%, të cilat janë 2 masa në vitin 2024, krahasuar me 0 masa në vitin 2023. Ndërkohë, vërejmë një ulje të numrit të masave që ndodhen në stadin 100% nga 5 masa në vitin 2023 në 2 masa në vitin 2024.

4.4 QP4: Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale


Figura 12 paraqet situatën e zbatimit të masave në kuadër të këtij qëllimi strategjik dhe shkallën e realizimit të tyre. Siç shihet, 2 masa nuk kanë filluar ende, ndërkohë që rreth 19 masa janë në proces realizimi por mbrapa afatit, si dhe 1 masë të realizuara plotësisht. Statusi total i zbatimit i përllogaritur në përqindje paraqitet me zbatueshmëri të mirë në **46% realizim**.

Objektivi Specifik	4.1	4.2	4.3	4.4
E pa gjurmuar	0	0	0	0
Pa filluar	0	0	0	2
Me vonesë	10	3	0	6
Në kohë	1	0	1	3
Përfunduar	1	0	0	0
Gabim	0	0	0	0
Realizimi në Përqindje (%)	51%	30%	70%	34%
Statusi i Objektivit	Shumë mirë	Mirë	Shumë mirë	Mirë

Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP4



Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP4



Zbatueshmëria e masave të QP4

Masa 4.1.1 “Rritja e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme”. Aktualisht, taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga: taksa mbi ndërtesat, taksa mbi truallin dhe taksa mbi tokën bujqësore. Ndërkohë, në projektligjin “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme” është parashikuar zgjerimi i kategorive të pasurive të paluajtshme. Me konkretisht, në këtë projektligj parashikohet se kategoritë e pasurive të paluajtshme që i nënshtrohen takses mbi pasurinë e paluajtshme janë:

- a) Pasuri e paluajtshme bujqësore-blegtorale;
- b) Pasuri e paluajtshme pyjore;
- c) Pasuri e paluajtshme rezidenciale;
- ç) Pasuri e paluajtshme tregtare;
- d) Pasuri e paluajtshme industriale;
- dh) Pasuri e paluajtshme shtetërore;
- e) Pasuri e paluajtshme fetare.

- **Realizimi 2023:** 51% | **Realizimi 2024:** 51%
- **Niveli i zbatimit** - Nuk ka progres te ri gjatë vitit 2024, pra masa nuk ka pësuar ndryshim në nivel realizimi krahasuar me vitin e kaluar

Për sa i përket **masës 4.1.2** “*Popullimi dhe përditësimi i kadastrës fiskale*”, Kadastra Fiskale përmban të dhëna në nivel kombëtar për qëllimet e llogaritjes së taksës mbi pasuritë e paluajtshme. Popullimi i vazhdueshëm i të dhënave në Kadastrën Fiskale është detyrim ligjor i njësive të vetëqeverisjes vendore. Në Kadastrën Fiskale janë regjistruar të dhëna për 1,2 milion njësi pronësore, nga të cilat për 412.689 njësi pronësore është regjistruar informacioni i plotë. Nga totali i të dhënave për njësitë pronësore të regjistruara në Kadastrën Fiskale, numri i njësive pronësore të taksueshme është 797.932 njësi. Përsa i përket nivelit të përdorimit të Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale (SIKF) nga bashkitë, nga të dhënat rezulton se aktualisht në sistem kanë të hapur një llogari rreth 223 përdorues, megjithatë, nivelet e përdorimit dhe popullimit me të dhëna të SIKF nga ana e bashkive janë të ulëta.

- **Realizimi 2023:** 51% | **Realizimi 2024:** 51%
- **Niveli i zbatimit** - Nuk ka progres të ri gjatë vitit 2024, pra masa nuk ka pësuar ndryshim në nivel realizimi krahasuar me vitin e kaluar.

Në lidhje me **masën 4.1.4** “*Ngritja e një sistemi monitorimi për taksën e pasurisë së paluajtshme*”, MF Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë (DPTP) është një person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat. DPTP ka si mision kryesor administrimin në nivel qendror nga pikëpamja ligjore dhe metodologjike të taksës vendore mbi pasuritë e paluajtshme. Gjithashtu, ndër të tjera DPTP monitoron dhe asiston njësitë e vetëqeverisjes vendore për procedurat e ndjekura në llogaritjen e bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme, me qëllim zbatimin e metodave të vlerësimit të vlerës së taksueshme, të përcaktuara në metodologjinë, si dhe analizon procesin e mbledhjes së taksës vendore mbi pasuritë e paluajtshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe kërkon informacion periodik mbi të ardhurat e realizuara nga taksa e pasurive të paluajtshme.

- **Realizimi 2023:** 51% | **Realizimi 2024:** 51%
- **Niveli i qëndrueshëm i zbatimit** - Nuk ka progres të ri gjatë vitit 2024, pra masa nuk ka pësuar ndryshim në nivel realizimi krahasuar me vitin e kaluar.

Sa i përket **masës 4.1.6** “*Zbatimi i ndarjes së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”*”, MF raporton se në zbatim të gërmës ç, pika 2 e nenit 25 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përfituese të 2% nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale që realizohen në juridiksionin e tyre. Në zbatim të sa më sipër dhe të pikës 109, të udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, për shpërndarjen e këtij burimi të ardhurash për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria e Financave çdo 4 muaj pas publikimit të treguesve fiskalë do t’i dërgojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vlerën takuese për t’u shpërndarë sipas bashkive. Kriteri i shpërndarjes së Tatimit mbi të Ardhurat Personale për çdo bashki do të jetë numri i popullsisë së përdorur për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2024. Në këtë kuadër, në vitin 2024 janë akorduar në total 1,289,931,200 lekë Tatim mbi të Ardhurat Personale për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

- **Realizimi 2023: 100% | Realizimi 2024: 100%**

Në lidhje me **masën 4.1.10** “Ngritja e një sistemi raportimi dhe rakordimi midis administratës qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për masën e rentës minerare të pagueshme”, MF ka raportuar se ka vazhduar gjatë vitit 2024 shpërndarja e rentës minerare bazuar në akt-rakordimet midis njësive vendore dhe tatimeve/doganave.

- **Realizimi 2023: 80% | Realizimi 2024: 90%**
- **Progres +10 pp** - Masa ka shënuar përparim gjatë vitit 2024, me vazhdimin e shpërndarjes së rentës minerare dhe përmirësim në procesin e rakordimit midis njësive vendore dhe administratës qendrore.

Masa 4.1.13 “Brenda politikave kombëtare makroekonomike e fiskale, në limitin vjetor të huamarrjes publike të përcaktohet një hapësirë e dedikuar për qeverisjen vendore”, Në zbatim të ligjit “Për Huamarrjen Vendore”, NJVV-të mund të aplikojnë në bankat e nivelit të dytë për të marrë hua por jo të gjitha njësitë vendore kanë kapacitet për të aplikuar për hua.

- **Realizimi 2024: 70%**

Në lidhje me **masën 4.2.1** “Integrimi i transfertave specifike në transfertën e pakushtëzuar (të përgjithshme dhe sektoriale) për menaxhimin e funksioneve”, MF raporton se aktualisht transfertat specifike i akordohet NJVQV-ve në formën e transfertës së pakushtëzuar (si transfertë sektoriale).

- **Realizimi 2023: 50% | Realizimi 2024: 50%**
- **Nivel i qëndrueshëm zbatimi.**

Masa 4.3.1 “Financimi nëpërmjet huamarrjes së njësive të qeverisjes vendore”, MF në zbatim të ligjit “Për Huamarrjen Vendore”, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë në bankat e nivelit të dytë për të marrë hua dhe se jo të gjitha njësitë vendore kanë kapacitet për të aplikuar për hua.

- **Realizimi 2023: 70% | Realizimi 2024: 70%**
- **Nivel i qëndrueshëm zbatimi.**

Për sa i përket **masës 4.4.2** “Hartimi i konceptit të detajuar për AFMIS dhe detajimi i zgjidhjes informatike dhe termat e referencës për ndërtimin e sistemit”, MF raporton financimin shtesë të miratuar nga Banka Botërore për shtrirjen e AFMIS-it në nivel vendor. MF ka vijuar punën nëpërmjet rregullave të vendosura në udhëzimet përkatëse për të konsoliduar buxhetimin në nivel produkti tek të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Përfundimi i këtij procesi do të përmbyllë një etapë të rëndësishme në rrugën drejt unifikimit në AFMIS të të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore.

- **Realizimi 2023:** 10% | **Realizimi 2024:** 40%
- **Progres +30 pp** - masa ka shënuar përparim të ndjeshëm gjatë vitit 2024, me avancim në konsolidimin e buxhetimit në nivel produkti dhe sigurimin e financimit shtesë për zgjerimin e AFMIS në nivel vendor.

Në lidhje me **masën 4.4.4** “Përmirësimi/konsolidimi i procesit të buxhetimit PBA në të gjitha NJVV-të”, dhe **masës 4.4.5** “Rishikimi i klasifikimit buxhetor për NJQV dhe lidhja me funksionet”, MF raporton se aktualisht janë në pilotim me metodologjinë e re të buxhetimit në 18 bashki dhe 3 qarqe. Gjatë vitit 2024 është monitoruar pilotimi i 12 bashkive në përgatitjen e buxhetit me një numër të reduktuar programesh dhe detajimin deri në nivel produkti, si dhe hartimi i buxhetit 2025 me metodologjinë e re.

- **Masa 4.4.4 Realizimi 2024:** 80%,
- **Masa 4.4.5 Realizimi 2024:** 80%.

Për sa i përket **masës 4.4.7** “*Rishikimi i kuadrit rregullator në drejtim të procesit të menaxhimit të aktiveve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në kuadrin rregullator të kontabilitetit të sektorit publik mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e secilës strukture të NJVV*” dhe **masës 4.4.10** “*Kompletimi i regjistrimit të plotë dhe të saktë të aktiveve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet implementimit të kontabilitetit mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në procesin e menaxhimit të aktiveve në sektorin publik (invenarizim, vlerësim, nxjerrje jashtë përdorimi)*”, Ministria e Financave, raporton se me mbështetjen e Bankës Botërore (BB) dhe Sekretariatit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), po zbaton një reformë të rëndësishme të kontabilitetit publik bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS). Një objektivi kryesor i projektit është miratimi i një ligji për kontabilitetin e sektorit publik dhe akteve të tjera nënligjore, bazuar në IPSAS. Pjesë e këtij kuadri rregullator të përditësuar është metodologjia në lidhje me inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve të sektorit publik. Gjithashtu, me mbështetjen e konsulentëve të projektit, në institucionet qendrore, në nivelin e njësisë kontrolluese, do të përgatitet një regjistër i konsoliduar i aseteve. Konkretisht, gjatë kësaj periudhe ka nisur procesi i angazhimit të konsulentëve vendas, të cilët, në bashkëpunim me DHMFKK, kanë ndërmarrë aktivitetet e para për hartimin e kuadrit rregullator në fushën e kontabilitetit të sektorit publik (ligji për kontabilitetin e sektorit publik dhe aktet nënligjore brenda vitit 2026).

- **Masa 4.4.7 Realizimi 2024:** 20%,
- **Masa 4.4.10 Realizimi 2024:** 20%

Ndërsa për **masën 4.4.8** “*Vlerësimi i aspekteve teknike për automatizimin e procesit të menaxhimit të aseteve vendore (në kuadrin e zgjerimit të SIMF në nivel vendor) të integruar me informacionin financiar periodik dhe vjetor mbi aktivet afatgjata të SIFQ*” dhe **masën 4.4.11** “*Përfaqshirja në SIFQ e kërkesave të NJVV për kontabilitetin rritës, menaxhimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe raportet financiare periodike & vjetore. (Përkon me procesin e zhvillimit /zgjerimit të mëtejshëm të Sistemit Informacionit Financiar të Qeverisë (SIFQ)*” raportojnë se do të realizohet zhvillimi i sistemit SIFQ bazuar në nevojat e

identifikuara të përgatitura gjatë fazës së parë të projektit të BB-së “Zhvillimi i kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri (IPSAS)” ku do të mundësojë përshtatjen e sistemit me metodologjinë e re kontabël, përmirësimin e konfigurimeve ekzistuese që sigurojnë regjistrimet kontabël dhe raportimin financiar si dhe automatizimin e proceseve të hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduara (brenda vitit 2027).

- **Masa 4.4.8 Realizimi 2024: 20%;**
- **Masa 4.4.10 Realizimi 2024: 20%;**
- **Masa 4.4.11 Realizimi 2023: 20%;**
- **Nivel i qëndrueshëm zbatimi.**


Masa 4.4.14 “*Forcimi i kapaciteteve vendore për menaxhimin e likuiditetit*”. Në udhëzimin plotësues të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 është miratuar përditësimi i parashikimeve mujore dhe ditore nga institucionet pilot të cilët përfaqësohen për qeverisjen vendore nga Bashkia Tiranë. Çdo fillim muaji nga struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër për menaxhimin e likuiditetit është gjeneruar realizimi mujor i planit të arkës dhe i është dërguar Bashkisë Tiranë, e cila ka përditësuar planin mujor të periudhës së mbetur të vitit. Për përditësimet e parashikimit ditor Bashkia Tiranë ka dërguar përpara dy javësh shkresat e njoftimit me protokoll për shpenzimet që do të kryhen mbi limitin e miratuar nga udhezimi i zbatimit të buxhetit 2024. Gjithashtu për avancimet është respektuar limiti mujor i miratuar në fillim të vitit duke kryer rregullimet midis zerave agregat (paga, operative dhe investime) për periudhën e mbetur të vitit.

- **Realizimi 2024: 30%**

Duke krahasuar realizimin e masave për vitin 2024 me vitin 2023, vërejmë një rënie të numrit të masave që nuk kanë nisur të realizohen, përkatësisht nga 3 masa krahasuar me 2023 në 2 masa. Gjithashtu, numri i masave në proces realizimi është rritur me 14 masa, nga 7 masa që kanë qenë në këtë stad në vitin 2023.

Gjithashtu shohim që masat që ndodhen në intervalin 51%–99%, kanë ruajtur të njejtin nivel prej 9 masash për të dy vitet.

Qëllimi Politik 4




Niveli i realizimit të masave të QP4 nga viti 2023 në 2024

4.5 QP 5: Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor


Figura 14 paraqet situatën e zbatimit të masave në kuadër të këtij qëllimi strategjik dhe shkallën e realizimit të tyre. Siç shihet, 1 masë nuk kanë filluar ende zbatimin, ndërkohë që 2 masa janë në proces realizimi si dhe 6 masa janë realizuar plotësisht. Statusi total i zbatimit i përlogaritur në përqindje paraqitet në **vlerën 66%**, duke e cilësuar një qëllim politik me realizueshmëri të mirë për kohëzgjatjen e planit të veprimit.

Objektivi Specifik	5.1	5.2	5.3
E pa gjurmuar	0	0	0
Pa filluar	0	1	0
Me vonesë	0	0	0
Në kohë	2	0	0
Përfunduar	1	1	4
Gabim	0	0	0
Realizimi në Përqindje (%)	80%	50%	100%
Statusi i Objektivit	Shumë mirë	Mirë	Shumë mirë

Statusi i zbatimit të tre objektivave specifike në QP5



Statusi i zbatimit të tre objektivave specifike të QP5



Zbatueshmëria e masave të QP5

Masa 5.1.1 “Konsolidim i rolit të NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mbivendosjet ligjore dhe administrative në marrëdhëniet me qeverisjen qendrore (kompetencat e Këshillit Bashkiak, konsultimi publik dhe vendimarrja e qytetarit)”. Gjatë vitit 2024 është vijuar me zbatimin e masave për forcimin e rolit të njësive të vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve të tyre, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Procesi është mbështetur nga zbatimi i rregulloreve të Këshillave Bashkiakë dhe programeve të transparencës, me synim qartësimin e kompetencave, rritjen e konsultimit publik dhe përmirësimin e vendimarrjes qytetare.

- **Realizimi 2023:** 20% | **Realizimi 2024:** 55%
- **Progres +35 pp** - masa ka pasur progres të dukshëm gjatë vitit 2024, me forcim të rolit të njësive vendore dhe zbatim më të gjerë të rregulloreve dhe programeve të transparencës për rritjen e konsultimit publik dhe qartësimin e kompetencave.

Masa 5.1.2 “Ndërtimi i një mekanizmi nxitës për rritjen e efikasitetit të Këshillave Bashkiakë duke pasur parasysh performancën e tij, komisionet bashkiake dhe aspekte të tjera lidhur me transparencën dhe llogaridhënien, duke marrë në konsideratë integrimin me bazë gjinore”. Kjo masë është zbatuar përmes forcimit të kapaciteteve të të zgjedhurve vendorë dhe përmirësimit të funksionimit të komisioneve pranë Këshillave Bashkiakë. Janë zhvilluar trajnime dhe aktivitete që synojnë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies, si dhe integrimin e perspektivës gjinore në proceset vendimarrëse vendore.

- **Realizimi 2023:** 0% | **Realizimi 2024:** 85%
- **Progres +85 pp** - Masa ka shënuar progres të madh gjatë vitit 2024, me rritje të ndjeshme të efikasitetit të këshillave bashkiakë përmes trajnimeve, forcimit të komisioneve dhe integritit të perspektivës gjinore në vendimmarrje.

Masa 5.1.3 *“Forcimi i kapaciteteve të Këshillave Bashkiakë dhe inkurajimi i shkëmbimit të praktikave të mira mbi transparencën, llogaridhënien dhe vendimmarrja mbi bazën e parimit të subsidiaritetit”.* Kjo masë është zbatuar në bashkëpunim me institucionet partnere, përmes zhvillimit të 22 trajnimeve në klasë për drejtuesit e këshillave dhe komisioneve bashkiake, ku morën pjesë 409 punonjës, si dhe 12 sesioneve informuese me 408 pjesëmarrës gjatë vitit 2024. Zbatimi i plotë i planifikuar ka sjellë një progres prej +50% krahasuar me vitin 2023, duke arritur realizim të plotë të masës, me përfundimin e ciklit të trajnimeve dhe sesioneve informuese për të gjitha bashkitë.

- **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +50 pp** - masa është realizuar plotësisht gjatë vitit 2024, me zhvillimin e trajnimeve dhe sesioneve informuese që kanë rritur ndjeshëm kapacitetet dhe transparencën e këshillave bashkiakë.

Masa 5.2.1 *“Koordinimi dhe bashkërendim me NJVV për hartimin e planeve të integritetit dhe Kodit të Sjelljes”.* Gjatë vitit 2024, AMVV ka ofruar asistencë dhe ekspertizë teknike për hartimin dhe finalizimin e Planeve të Integritetit të njërive të vetëqeverisjes vendore. Janë asistuar 47 bashki në përgatitjen e këtyre dokumenteve strategjike, duke synuar forcimin e integritetit institucional dhe rritjen e transparencës në nivel lokal. Masa është realizuar, duke reflektuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri krahasuar me vitin 2023.

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Për masën 5.3.1 *“Forcimi i rolit të Njësive të BE-së për të koordinuar dhe marrë pjesë në proceset e zhvillimit të politikave bashkiake”.* Kjo masë është zbatuar në bashkëpunim me projektin *“Bashki të Forta”* përmes zhvillimit të 22 trajnimeve në klasë për drejtuesit e këshillave dhe komisioneve bashkiake, ku morën pjesë 409 punonjës, si dhe 12 sesioneve informuese me 408 pjesëmarrës. Aktivitetet kanë synuar përmirësimin e koordinimit dhe rritjen e kapaciteteve të njësive të BE-së në proceset e zhvillimit të politikave vendore.

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 5.3.2 *“Shtrirja e proceseve të integritetit në BE përtej njësive të BE, duke siguruar përfshirjen dhe kontributin e duhur të gjithë administratës vendore”.* Kjo masë është zbatuar në bashkëpunim me projektin *“Bashkitë për në Evropë”* përmes zhvillimit të 27 trajnimeve rajonale, ku morën pjesë 486 pjesëmarrës. Aktivitetet kanë synuar rritjen e kapaciteteve të Strukturave të Integritetit Evropian pranë bashkive, duke përfshirë temat si: procesi i negociatave dhe roli i bashkive; shkrimi i suksesshëm i projekt-propozimeve sipas thirrjeve të hapura në programet evropiane (Horizon Europe dhe CERV); procedurat e prokurimit të BE-

së (PRAG); si dhe trajnimet për sekretarët e përgjithshëm, nënkryetarët dhe trupën menaxheriale të bashkive.

- **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +50 pp** - masa është zbatuar plotësisht gjatë vitit 2024, me zgjerimin e përfshirjes së administratës vendore në proceset e integritit dhe forcimin e kapaciteteve të bashkive përmes trajnimeve rajonale dhe bashkëpunimit me projektin “Bashkitë për në Evropë”.


Masa 5.3.3 *“Zhvillimi i udhëzimeve ndihmuese për administratën vendore lidhur me agjendën e integritit evropian në nivel vendor”*. Në bashkëpunim me projektin SECO “Financat Lokale”, është hartuar kurrikula për administratën vendore me fokus në funksionin e Shërbimit të Taksapaguesve, transparencën në llogaritjen dhe mbledhjen e detyrimeve vendore, si dhe menaxhimin e ankesave dhe procedurave të apelimit administrativ në nivel vendor. Kjo iniciativë ka përmirësuar udhëzimin dhe mbështetjen për njësitë vendore në zbatimin e agjendës së integritit evropian, duke siguruar një referencë praktike dhe funksionale për administratën lokale dhe duke çuar përpara progresin mbi nivelin bazë të pritshëm.

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 5.3.4 *“Krijimi i një sistemi monitorimi dhe raportimi për projektet e zbatuara nga NJVV”*. Kjo masë përfshin miratimin e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 10, datë 12.07.2024, “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”. Udhëzimi përcakton që projektet me financim të huaj të menaxhohen përmes skemës së plotë të Thesarit, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në marrëveshje. Si rrjedhojë, ecuria e zbatimit të tyre monitorohet nëpërmjet Sistemit të Thesarit, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Qëllimi Politik 5



Niveli i realizimit të masave të QP5 nga viti 2023 në 2024


Vërejmë një rritje të numrit të masave që ndodhen në stadin 100% nga 3 masa në vitin 2023 në 6 masa në vitin 2024.

4.6 QP6: Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore dhe i një koordinimi e qeverisjeje funksionale gjithëpërfshirëse të aktorëve të decentralizimit


Figura paraqet situatën e zbatimit të masave në kuadër të këtij qëllimi strategjik dhe shkallën e realizimit të tyre. Siç shihet, 1 masë është jashtë afatit me ecurinë sipas planit të veprimit, e cila ska filluar ende të zbatohet, ndërkohë që 4 masa janë në proces realizimi dhe 11 masa janë realizuar plotësisht. Statusi total i zbatimit i përllogaritur në përqindje paraqitet në **vlerën 73%**.

Objektivi Specifik	6.1	6.2	6.3	6.4	6.5
E pa gjurmuar	0	0	0	0	0
Pa filluar	0	0	1	0	0
Me vonesë	0	0	0	0	1
Në kohë	6	1	0	1	2
Përfunduar	5	4	1	1	0
Gabim	0	0	0	0	0
Realizimi në Përqindje (%)	84%	95%	50%	78%	57%
Statusi i Objektivit	Shumë mirë	Shumë mirë	Mirë	Shumë mirë	Shumë mirë

Statusi i zbatimit të pesë objektivave specifike të QP6



Statusi i zbatimit të pesë objektivave specifike në QP6



Zbatueshmëria e masave të QP6

Në lidhje me **masën 6.1.1** të “*Vlerësimit kombëtar për trajnim të vazhdueshëm bazuar në nevoja*”. Kjo masë ka përfshirë mbështetjen e administratës vendore përmes trajnimeve që synojnë përmbushjen e detyrave funksionale, arritjen e objektivave konkrete të punës dhe zhvillimin personal të individëve. ASPA ka zhvilluar periodikisht procesin e vlerësimit të nevojave për trajnim për vitin 2024 dhe ka pasqyruar rezultatet e mbledhura në kalendarin e trajnimeve 2024–2025.

- **Realizimi 2023: 25% | Realizimi 2024: 100%**
- **Progres +75 pp** - masa është realizuar plotësisht gjatë vitit 2024, me vlerësimin e nevojave për trajnim dhe organizimin e kalendarit të trajnimeve për administratën vendore.

Masa 6.1.2 “*Krijimi i një strukture të dedikuar të trajnimit (Akademia e Trajnimit) të administratës në nivel vendor, përfshirë të zgjedhurit vendor*”. Referuar iniciativës së Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor për fuqizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, është ngritur grupi ndërinstitutional i punës me Urdhër të Kryeministrit nr. 6, datë 12.01.2024, për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve dhe të zgjedhurve vendorë. Viti 2024 shërben si vit tranzitor, ku AMVV ka qenë institucioni përgjegjës për koordinimin e iniciativave për ofrimin e trajnimeve, përmes Drejtorisë së Trajnimit dhe Fuqizimit të Kapaciteteve. Struktura ka ofruar asistencë teknike, ka zhvilluar trajnime bazuar në nevojat e pushtetit vendor, ka shpërndarë praktika të mira dhe ka zhvilluar platformën e njohurive.

Bashkëpunimi me projektin BPE ka mundësuar përfundimin e ciklit të trajnimeve për procedurat e prokurimeve sipas rregullave të BE-së, duke vijuar procesin e nisur gjatë vitit 2023. Realizimi i masës ka arritur 80%, duke shënuar progres të konsiderueshëm dhe konsolidimin e iniciativës për krijimin e Akademisë së Pushtetit Vendor.

- **Realizimi 2023:** 30% | **Realizimi 2024:** 80%
- **Progres +50 pp** - masa ka shënuar progres të konsiderueshëm gjatë vitit 2024, me avancim në krijimin e Akademisë së Trajnimit dhe ofrimin e trajnimeve për administratën dhe të zgjedhurit vendor.

Në lidhje me **masën 6.1.3** “*Analiza e nivelit të pagave dhe rishikimi (rritja) e nivelit të pagave të nëpunësve në NJVV, për të siguruar qëndrueshmëri të nëpunësve ekzistues dhe tërheqjen e nëpunësve të rinj të talentuar dhe profesionistë*”. Rritja e pagave është realizuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 01.08.2024, për ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.05.2023, duke përfshirë klasifikimin e funksioneve dhe kufijtë e pagave për funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore. Masa është zbatuar në tërësi, duke siguruar qëndrueshmëri të stafit ekzistues dhe duke përmirësuar aftësinë për të tërhequr talentë dhe profesionistë të rinj në administratën vendore.

- **Realizimi 2023:** 0% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +100 pp** - masa është zbatuar plotësisht gjatë vitit 2024, me rritjen e pagave që ka siguruar stabilitet për stafin ekzistues dhe ka përmirësuar tërheqjen e talentëve të rinj në administratën vendore.

Në lidhje me **masën 6.1.4** “*Ngritja e kapaciteteve të nëpunësve publikë përmes zbatimit të programeve të trajnimit dhe internship-it, dedikuar nëpunësve civilë të rinj*”. 23 nëpunës civilë të institucioneve të administratës publike, përfshirë edhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, zhvilluan trajnime praktike, sesione mentorimi, Workshop-e, vizita studimore dhe internship/praktika pune në kuadër të programit “Ngritja e kapaciteteve për nëpunësit civilë të administratës publike / Young Cells”. Aktivitetet u zhvilluan në shkollat dhe administratat e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: Francë, Itali, Gjermani dhe Kroaci, duke kontribuar në fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe përgatitjen e të rinjve për sfidat e punës në administratën publike.

- **Realizimi 2023:** 90% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +10 pp** - masa është përmbushur plotësisht gjatë vitit 2024, me zhvillimin e trajnimeve dhe praktikave që kanë forcuar kapacitetet profesionale të nëpunësve civilë të rinj.

Masa 6.1.5 “*Vlerësim për përmirësimin e funksionaliteteve të platformës “Administrata.al”*”. Vlerësimi dhe përmirësimi i funksionaliteteve të platformës “Administrata.al” u përfundua gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, me qëllim të reflektonin nevojat e institucioneve, përfshirë edhe nivelin vendor, për një menaxhim të unifikuar të burimeve njerëzore. Gjatë

gjashtëmuorit të dytë u realizua testimi i funksionaliteteve kryesore të platformës, duke siguruar përmirësimin e performancës dhe përdorshmërisë së saj për administratën publike.

Realizimi 2023: 0% | Realizimi 2024: 100%

- **Realizimi 2023: 0% | Realizimi 2024: 100%**
- **Progres +100 pp** - masa është realizuar plotësisht gjatë vitit 2024, me përmirësimin dhe testimin e funksionaliteteve të platformës “Administrata.al” për një menaxhim më efektiv dhe të unifikuar të burimeve njerëzore.

Masa 6.1.6 *“Vlerësimi i Nevojave për Trajnim për përdorimin e platformës “Administrata.al”* për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave për trajnim të stafit në nivel qendror dhe vendor dhe hartimi i planit të trajnimeve për NJVV mbi përdorimin e portalit “Administrata.al”. Hartimi i planit të trajnimeve për stafin në nivel vendor të NJVV-së mbi përdorimin e portalit “Administrata.al” dhe Regjistrin HRMIS u përfundua në tremujorin e fundit të vitit 2024. Ky plan është bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim, duke siguruar që stafi në nivel qendror dhe vendor të përgjigjet në mënyrë efektive ndaj nevojave të tij për përdorimin e platformës.

- **Realizimi 2023: 75% | Realizimi 2024: 100%**
- **Progres +25 pp** - masa është përmbushur gjatë vitit 2024, me hartimin e planit të trajnimeve që siguron përdorimin efektiv të platformës “Administrata.al” nga stafi në nivel qendror dhe vendor.

Masa 6.1.7 *“Ngritja e kapaciteteve të Njësive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të NJVV-ve për përdorimin e platformës “Administrata.al”*. Departamenti i Administratës Publike ka bashkëpunuar me donatorët për të adresuar nevojat për trajnim të Njësive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të NJVV-ve dhe për ngritjen e help-desk-ut pranë DAP. Ky mekanizëm ka ofruar asistencë teknike për përdorimin e platformës “Administrata.al”, duke mbështetur stafin vendor në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe funksionimin efikas të portalit.

- **Realizimi 2023: 30% | Realizimi 2024: 50%**
- **Progres +20 pp** - masa ka shënuar përparim gjatë vitit 2024, duke forcuar kapacitetet e Njësive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe ofruar mbështetje teknike për përdorimin efektiv të platformës “Administrata.al”.

Masa 6.1.8 *“Rritja e përdorimit të funksionaliteteve të platformës ‘Administrata.al’, për menaxhimin e burimeve njerëzore nga ana e NJVV përfshirë dhe raportimin periodik.”* Nga ana e DAP raportohet se lidhur me rritjen e përdorimit të platformës së integruar të bashkëpunimit Administrata.al, me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës “Mbështetja e Reformës së Administratës Publike në Nivel Vendor në Shqipëri”, financuar nga qeveria gjermane, DAP dhe KMSHC parashikojnë të ndërmarrin disa masa si zhvillimi i trajnimeve me përdoruesit e platformës, përgatitja e video-tutorialeve për përdorimin e funksionaliteteve specifike të platformës, si dhe një help-desk të dedikuar për të mbështetur nëpunësit, veçanërisht ata në nivel vendor. Të gjitha këto aktivitete do të zhvillohen gjatë tremujorit të

fundit të vitit 2024. Platforma Administrata.al, së bashku me Sistemin e Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS), janë pjesë e një ndërhyrjeje nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila pritet të finalizohet në Shtator të vitit 2024, çka do të mundësojë zhvillimin e trajnimeve me nëpunësit e nivelit qendror dhe vendor.

- **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 60%
- **Progres +10 pp** - masa ka shënuar përparim gjatë vitit 2024, me aktivitete të planifikuara për trajnime, video-tutoriale dhe mbështetje teknike që synojnë rritjen e përdorimit të platformës “Administrata.al” nga NJVV-të.

Masa 6.1.9 *“Hartimi dhe integrimi i kuadrit/kornizës së kompetencave për burimet njerëzore të NJVV në planin e trajnimit të ASPA-së”*. Me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës “Mbështetja e Reformës së Administratës Publike në Nivel Vendor në Shqipëri”, është përgatitur një raport me rekomandime për zhvillimin e Kuadrit të Kompetencave për nëpunësit civilë në nivel qendror dhe vendor. Gjithashtu, është hartuar një draft Kuadër Kompetencash Thelbësore (core) për nëpunësit civilë në nivel vendor, duke marrë si shembull Bashkinë e Tiranës. Theksohet se miratimi i kuadrit të kompetencave për shërbimin civil është një nga masat e parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030. Realizimi i plotë i kësaj mase do të varet nga miratimi i ndryshimeve në Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”. Referuar Planit të Veprimit të SNRAP 2025-2027, kuadri i kompetencave është planifikuar të realizohet deri në fund të vitit 2026.

- **Realizimi 2023:** 75% | **Realizimi 2024:** 75%
- **Nivel i qëndrueshëm zbatimi**

Masa 6.1.10 *“Hartimi i strategjisë/planit për zhvillimin e kapaciteteve të zgjedhurve dhe zyrtarëve të tjerë të NJVV-ve në 61 bashkitë dhe 12 këshillat e qarqeve”*. Agjencia ka vijuar mbështetjen për rritjen e kapaciteteve të zgjedhurve dhe administratës vendore gjatë vitit 2024, përmes hartimit të tre kurrikulave trajnimi për këshillat bashkiakë dhe administratën vendore, që përfshijnë:

- Planifikimin dhe buxhetimin strategjik për qeverisjen e mirë bashkiake;
- Zhvillimin Ekonomik Vendor – planifikim, zbatim dhe raportim;
- Politikat dhe instrumentet për zbatimin e shërbimeve bashkiake.

Këto kurrikula synojnë forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionalizimin e vendimmarrjes vendore, duke përmirësuar aftësitë për menaxhimin strategjik dhe efektiv të funksioneve të NJVV-ve.

- **Realizimi 2023:** 75% | **Realizimi 2024:** 80%
- **Progres +5 pp** - masa ka vazhduar të përparojë gjatë vitit 2024, me hartimin e kurrikulave të trajnimit që synojnë forcimin e kapaciteteve dhe profesionalizimin e vendimmarrjes në NJVV.

Masa 6.1.11 “*Krijimi i modeleve të matjes së performancës në nivel vendor bazuar në rezultate krahasimore*”. Me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës “Mbështetja e Reformës së Administratës Publike në Nivel Vendor në Shqipëri” dhe nëpërmjet angazhimit të ekspertizës ndërkombëtare dhe kombëtare, është hartuar një udhëzues për përmirësimin e procesit të vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë. Rishikimi i procesit të vlerësimit individual të performancës është një nga masat e parashikuara në Udhërrëfyesin për RAP 2023-2030 dhe në Strategjinë Ndërsektoriale të RAP 2025-2030, me synimin për të rritur objektivitetin dhe për të garantuar harmonizim me performancën institucionale. Realizimi i plotë i kësaj mase varet nga miratimi i ndryshimeve në Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”. Sipas Planit të Veprimit të SNRAP 2025-2027, rishikimi i metodologjisë për vlerësimin e punës pritet të finalizohet deri në fund të vitit 2026.

- **Realizimi 2023:** 75% | **Realizimi 2024:** 75%
- **Nivel i qëndrueshëm zbatimi**

Masa 6.2.1 “*Identifikim dhe vlerësimi i marrëdhënieve dhe roleve të institucioneve qendrore dhe vendore në mbështetje të qeverisjes vendore*”. Gjatë vitit 2024, AMVV ka ushtruar rolin e saj ndërmjetësues duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet bashkive dhe institucioneve qendrore. Agjencia ka mbështetur bashkitë në marrëdhëniet me SASPAC në çështjet e rimbursimit të TVSH-së, si dhe në proceset e regjistrimit dhe administrimit të projekteve me financim të huaj në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Thesarin e Shtetit, në zbatim të Udhëzimit nr. 10, datë 12.07.2024. Gjithashtu, janë konsoliduar marrëdhëniet me MSHMS, MBZHR dhe MA në kuadër të decentralizimit horizontal, duke siguruar mbështetje dhe koordinim të shtuar në fushat përkatëse. Në vijim, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet AMVV-së dhe Qendrës për Zhvillim Rajonal dhe Vendor (UT). Rezultatet e vitit 2024 tregojnë përparim të ndjeshëm krahasuar me vitin 2023, duke rritur eficiencën, transparencën dhe bashkëpunimin ndërinstitutional në administrimin e fondeve dhe shërbimeve publike.

Realizimi 2023: 0% | **Realizimi 2024:** 75%

- **Progres +75 pp** - masa ka shënuar progres të konsiderueshëm gjatë vitit 2024, duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet bashkive dhe institucioneve qendrore dhe duke përmirësuar procedurat për administrimin e fondeve me financim të huaj.

Masa 6.2.2 “*Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Çështjeve Vendore dhe AMVV për vlerësim, monitorim dhe zbatim të agjendës së decentralizimit*”. Gjatë vitit 2024, aktivitetet e Drejtorisë së Çështjeve Vendore dhe AMVV-së janë orientuar drejt forcimit të kapaciteteve për vlerësim, monitorim dhe zbatim të agjendës së decentralizimit. Ky proces ka vazhduar të mbështesë funksionimin efektiv të mekanizmave të decentralizimit dhe koordinimin ndërinstitutional në nivel vendor. Referuar realizimeve të vitit 2023, ku ky aktivitet ishte përfunduar plotësisht, viti 2024 ka shërbyer për konsolidimin e kapaciteteve dhe ruajtjen e standardeve të vendosura në vitin paraprak, duke siguruar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri në implementimin e politikave të decentralizimit.

- **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 6.2.3 *“Forcimi i rolit të Grupit Tematik të Decentralizimit në diskutimin e agjendës së decentralizimit dhe koordinimin me donatorët”.* Gjatë vitit 2024, Grupi Tematik i Decentralizimit ka vijuar të mbajë funksionin e tij kyç në diskutimin e agjendës së decentralizimit dhe koordinimin me donatorët, duke siguruar vazhdimësinë e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve vendorë dhe partnerëve ndërkombëtarë. Ky aktivitet konsolidoi arritjet e vitit 2023, kur masa u realizua plotësisht, duke ruajtur efektivitetin e Grupit dhe standardet e vendosura në diskutimin e politikave të decentralizimit.

- **Realizimi 2023:** 0% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +100 pp** - masa është realizuar plotësisht gjatë vitit 2024, duke forcuar rolin e Grupit Tematik të Decentralizimit në koordinimin me donatorët dhe diskutimin e agjendës së decentralizimit.

Masa 6.2.4 *“Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të funksionimit të Këshillit Konsultativ për rritjen e rolit të tij proaktiv nën dialogun ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.”* Gjatë vitit 2024 është përfunduar rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për funksionimin e Këshillit Konsultativ, me qëllim forcimin e rolit të tij proaktiv në dialogun ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore. Procesi u finalizua me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 17.04.2024, që ndryshon dhe plotëson VKM nr. 910, datë 21.12.2016, duke përmirësuar mekanizmat e konsultimit dhe pjesëmarrjes së njësive vendore në proceset vendimmarrëse. Krahësuar me vitin 2023, kur realizimi ishte 20%, gjatë vitit 2024 është arritur avancim i dukshëm, duke siguruar ndryshime ligjore që konsolidojnë funksionimin dhe rrisin rolin proaktiv të Këshillit Konsultativ në proceset vendimmarrëse.

- **Realizimi 2023:** 20% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +80 pp** - masa është realizuar plotësisht gjatë vitit 2024, me rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullator që ka forcuar rolin proaktiv të Këshillit Konsultativ në dialogun ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore.

Masa 6.2.5 *“Forcimi i rolit të Këshillit Konsultativ në përforcimin e dialogut ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, për koordinimin e veprimtarive dhe analizën e legjislacionit për shqyrtim, si edhe rritja e rolit të qeverisjes vendore në procesin konsultues të projektakteve lidhur me standardet e shërbimeve vendore.”* Gjatë vitit 2024 është forcuar roli funksional i Këshillit Konsultativ në drejtim të dialogut ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, me fokus në koordinimin e veprimtarive dhe analizën e projektakteve ligjore që prekin standardet e shërbimeve vendore.

- **Realizimi 2023:** 50% | **Realizimi 2024:** 100%
- **Progres +5 pp** - masa është realizuar plotësisht gjatë vitit 2024, me forcimin e rolit të Këshillit Konsultativ në dialogun ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore dhe përmirësimin e transparencës dhe efektivitetit të procesit konsultues.

Masa 6.3.1 *“Vlerësimi i gatishmërisë për decentralizim të mëtijshëm sipas funksioneve specifike dhe tipareve të veçanta bashkiake”.* Si vijim i progresit të mëparshëm, u ngrit grupi

ndërinstitucional i punës për hartimin e mekanizmit pilot “decentralizim horizontal”, në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr. 81, datë 15.05.2024. Ky mekanizëm mbulon funksionet e përbashkëta në arsimin, bujqësinë dhe shëndetësinë, duke përfshirë bashkitë në procesin e koordinuar me pushtetin qendror. Nëntorin e vitit 2024, u firmosën marrëveshjet mes katër bashkive (Kolonjë, Berat, Shkodër dhe Divjakë) dhe institucioneve përgjegjëse (MBZHR, MA dhe MSHMS), duke mundësuar vlerësimin e gatishmërisë për funksione të reja dhe avancimin e kapaciteteve vendore. Referuar zhvillimeve të vitit të kaluar, arritja e këtyre marrëveshjeve përfaqëson një hap përpara në konsolidimin e decentralizimit horizontal dhe përgatitjen e bashkive për transferimin e kompetencave të reja.

➤ **Realizimi 2023:** 100% | **Realizimi 2024:** 100%

Masa 6.4.1 “Rishikimi i kuadrit ligjor të institucionit të prefektit.” Si rezultat i reformave legjislativë dhe rregullatore, u miratuan ndryshimet e Ligjit nr. 36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 107/2016 ‘Për Prefektin e Qarkut’”, si dhe një seri urdhrash që konsolidojnë funksionimin dhe organizimin e institucionit:

- Urdhri nr. 21, datë 05.02.2025, “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, i Kryeministrit;
- Urdhri nr. 39, datë 20.02.2025, “Për miratimin e rregullorës së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, së bashku me Aneksin I mbi procedurat e verifikimit dhe kontrollit;
- Urdhri nr. 74, datë 24.04.2025, “Për raportimin mbi veprimtarinë e prefektit të qarkut”;
- Urdhri nr. 93, datë 12.06.2025, “Për miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut në ushtrimin e funksioneve të institucionit të prefektit të qarkut”.

Ky paketim legjislativ dhe rregullator siguron një **rritje pozitive**, duke miratuar kuadrin ligjor dhe rregulloret e brendshme për forcimin e funksionimit dhe koordinimit të institucionit të prefektit.

➤ **Realizimi 2023:** 20% | **Realizimi 2024:** 100%

➤ **Progres +80 pp** - masa është realizuar plotësisht gjatë vitit 2024, me miratimin e kuadrit ligjor dhe rregulloreve që forcojnë funksionimin dhe koordinimin e institucionit të prefektit.

Masa 6.4.2 “*Forcimi i monitorimit dhe rritja e bashkëpunimit të institucionit të prefektit me degët territoriale, përfshirë edhe rolin në monitorimin e standardeve kombëtare.*” Si pjesë e përpjekjeve për avancimin e funksionit të monitorimit, aktiviteti është udhëhequr në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme. Prefekti i Qarkut ka kërkuar dërgimin e analizave gjashtëmujore dhe vjetore mbi veprimtarinë e degëve territoriale, të cilat përfshijnë objektivat e përcaktuara për vitin përkatës, zbatimin e detyrave funksionale, të dhëna statistikore dhe problematikat e hasura gjatë punës. Megjithatë, procesi i monitorimit përballet me kufizime ligjore dhe proceduriale, pasi institucionet qendrore në qark kanë ligje organike që kufizojnë varësinë dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut. Këto kufizime nuk pengojnë

monitorimin në përgjithësi, por kërkojnë një koordinim të shtuar dhe respektim të hierarkisë ligjore për të siguruar efikasitet në përmbushjen e detyrave funksionale të degëve territoriale. Procesi vazhdon të jetë në zhvillim dhe përfaqëson një **evolucion gradual**, ku monitorimi funksionon por me disa kufizime të natyrës ligjore.

- **Realizimi 2023: 0% | Realizimi 2024: 55%**
- **Progres +55 pp** - Masa ka shënuar progres gjatë vitit 2024, me avancim në monitorimin dhe koordinimin e degëve territoriale nga Prefekti, megjithë kufizimet ligjore që ndikojnë në kapacitetin e kontrollit të drejtpërdrejtë.


Masa 6.5.1 *“Ofrimi dhe ndarje e njohurive/eksperiencave nga shoqatat”*. Gjatë vitit 2024, Shoqata Kombetare e Bashkive të Shqipërisë ka mundur ofrimin dhe ndarjen e njohurive dhe eksperiencave mes bashkive anëtare, në drejtim të avancimit të procesit të decentralizimit funksional, forcimit të advokatisë për përmirësimin e kuadrit ligjor që mbështet autonominë vendore, përmirësimin të klimës së biznesit dhe rritjes së transparencës, si dhe shkëmbimit të praktikave të mira mbi zhvillimin e ekonomisë lokale, forcimin e shërbimeve sociale dhe përmirësimin e infrastrukturës kapitale.

- **Realizimi 2023: 20% | Realizimi 2024: 85%**
- **Progres +65 pp.**

Për masën 6.5.2 *“Ngritja / rijetëzimi pranë shoqatave i forumeve profesionale në ndihmë të ndërveprimit mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore”*, në këtë kuadër, gjatë këtij viti janë ngritur dhe ri-jetëzuar pranë shoqatave forume profesionale sektoriale si Forumi Social, Forumi i Energjisë dhe Klimës, Forumi i Ujësjetës dhe Menaxhimit të Mbetjeve dhe Forumi i Financave Lokale, të cilët kanë shërbyer si instrumente teknike dhe politike për forcimin e ndërveprimit mes qeverisjes qendrore dhe vendore. Si rezultat, në vitin 2024 janë hartuar rekomandime dhe propozime për Projektligjin e ri të Menaxhimit të Mbetjeve, si dhe është aktivizuar Forumi i Financave Vendore me kontribut konkret në hartimin e rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të financave vendore.

- **Realizimi 2023: 0% | Realizimi 2024: 85%**
- **Progres +85 pp.**

Qëllimi Politik 6



Niveli i realizimit të masave të QP6 nga viti 2023 në 2024

Duke krahasuar realizimin e masave për vitin 2024 me vitin 2023, vërejmë një rënie të numrit të masave që nuk kanë nisur të realizohen, përkatësisht nga 8 masa në 2023 krahasuar me 2 masa të vitit 2024. Gjithashtu, numri i masave në proces realizimi ka rënë me 5 masa, nga 6 në 1 masë në vitin 2024.

Gjithashtu masat që ndodhen në intervalin 51%–99%, të cilat janë 9 masa në vitin 2024, krahasuar me 7 masa në vitin 2023 kanë shënuar një rritje. Ndërkohë, vërejmë një rritje të numrit të masave që ndodhen në stadin 100% nga 2 masa në vitin 2023 në 11 masa në vitin 2024.

Disa nga arritjet dhe sfidat nga monitorimi për vitin 2024

QP1. Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

Niveli i realizimit për vitin 2024: 67%

Arritjet kryesore

- Aplikacioni TEA u funksionalizua plotësisht për menaxhimin e të dhënave të trashëgimisë kulturore, duke arritur 100% realizim (nga 20% në vitin 2023).

- Mbi 120 specialistë nga 58 bashki u trajnuan mbi vlerësimin e kapitalit natyror, duke rritur kapacitetet vendore dhe duke pilotuar metodologjinë në 4 bashki.

Sfidat kryesore

- Vetëm 3 bashki kanë strategji për përdorimin e aseteve vendore, ndërsa shumica disponojnë vetëm inventar fizik pa kapacitete për menaxhim dhe gjenerim të ardhurash.
- Studimi i parafizibilitetit për 430 diga mbetet i pandryshuar në 30% realizim, për shkak të vonesave institucionale dhe financiare.
- Bashkëpunimi ndërmjet bashkive për planet e mbarështimit të pyjeve mbetet i kufizuar, me vetëm 13 bashki të përfshira.
- Portali “ujitja.al” ende nuk ka të dhëna raportuese, duke treguar nevojën për përmirësim të përdorimit operacional të sistemeve të ngritura.

QP2. Përmirësimi i cilësisë dhe standardeve të shërbimeve publike vendore **Niveli i realizimit për vitin 2024: 79%**

Arritjet kryesore

- U finalizua Raporti Kombëtar i Performancës për 61 bashki, bazuar në 40 tregues, si dhe u hartuan manualët orientues për strukturat organizative.
- U forcua shërbimi i kujdesit shoqëror përmes financimit të 29 shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, trajnimit të 314 punonjësve dhe hartimit të Hartës së Shërbimeve Sociale 2025 për të gjitha bashkitë.
- Sistemi i strehimit social u shtri në 56 bashki, ndërsa kuadri rregullator për menaxhimin e zonave të mbetjeve pati progres të ndjeshëm.
- U përmirësua kuadri rregullator për Policinë Bashkiake dhe avancoi pilotimi i decentralizimit arsimor në 4 bashki.

Sfidat kryesore

- Mbetet i paplotësuar zhvillimi dhe zbatimi i standardeve minimale kombëtare për shërbimet publike, me disa masa ende pa progres.
- Ka vonesa në hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike për emergjencat civile, duke ndikuar në përgatitjen e bashkive.
- Procesi i digjitalizimit të shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri ka mbetur i pandryshuar për shkak të vonesave ligjore.
- Vijnë sfidat në harmonizimin e kompetencave të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve (UKN) me kuadrin institucional dhe ligjor, duke evidentuar nevojën për qartësimin e roleve dhe përgjegjësisë ndërmjet bashkive, shoqërive UKN dhe institucioneve përgjegjëse në nivel qendror.

QP3. Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre

Niveli i realizimit për vitin 2024: 53%

Arritjet kryesore

- U ngrit Grupi i Përbashkët i Punës për ri-inxhinierimin dhe digjitalizimin e shërbimeve vendore dhe u miratua lista e shërbimeve prioritare për digjitalizim.
- Sistemi e-gjopa për Policinë Bashkiake pati avancim për disa bashki, duke shërbyer si model për zbatimin e shpejtë të zgjidhjeve digjitale.
- Programi GovTech AF u miratua dhe u dakordësuan hapat për integrimin e shërbimeve prioritare në e-Albania 2.0.
- Sistemet elektronike dhe faqet zyrtare të bashkive shënuan progres, duke eliminuar masat e pazbatuara krahasuar me vitin 2023.

Sfidat kryesore

- Pjesa më e madhe e masave mbetet në nivele realizimi 35–55%, duke treguar se kuadri institucional është ngritur, por zbatimi praktik është ende i kufizuar.
- Sistemet digjitale për taksat, financat vendore, punët publike dhe aktet e këshillave bashkiakë kanë progres të ulët dhe kërkojnë përshejtim.
- Shërbimet elektronike në e-Albania dhe sistemet e aplikimeve janë në proces, por kapacitetet teknike dhe TIK të bashkive mbeten një pengesë kryesore.
- Zbatimi i programit GovTech shtrihet përtej periudhës aktuale të planit, duke krijuar rrezik për vonesa në arritjen e objektivave.

QP4. Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale

Niveli i realizimit për vitin 2024: 46%

Arritjet kryesore

- U zbatua plotësisht ndarja e 2% të TAP-it për bashkitë, me rreth 1.28 miliardë lekë të alokuara për NJVV-të, duke konsoliduar një mekanizëm të qëndrueshëm financiar vendor.
- Sistemi AFMIS u zgjerua dhe 18 bashki e 3 qarqe po pilotojnë metodologjinë e re të buxhetimit, duke përmirësuar standardizimin e proceseve financiare.
- U rrit progresi në shpërndarjen e rentës minerare, duke përmirësuar transparencën në menaxhimin e të ardhurave nga burimet natyrore.
- U forcua dialogu ndërinstitutional për financat vendore, me rritjen e nivelit të adresimit të rekomandimeve nga ministritë.

Sfidat kryesore

- Taksa e pasurisë së paluajtshme mbetet pa progres të rëndësishëm, me realizim të pandryshuar dhe kontribut të ulët në të ardhurat vendore.
- Zbatimi i standardeve të kontabilitetit IPSAS mbetet në fazë fillestare për shkak të mungesës së plotësimit të kuadrit ligjor.
- Kapacitetet e bashkive për huamarrje vendore dhe përgatitje projektesh financimi mbeten të kufizuara.
- Hendeku financiar për zbatimin e planit të veprimit vijon të jetë i paadresuar.

QP5. Demokracia vendore dhe integrimi evropian

Niveli i realizimit për vitin 2024: 66%

Arritjet kryesore

- U realizuan plotësisht 6 masa, përfshirë trajnimin e 409 punonjësve të këshillave bashkiakë dhe zhvillimin e 27 trajnimeve rajonale për integrimin evropian me 486 pjesëmarrës.
- U shënuar progres i rëndësishëm në forcimin e rolit të këshillave bashkiakë përmes mekanizmave nxitës dhe përfshirjes së perspektivës gjinore në funksionimin e tyre.
- U asistuan 47 bashki për hartimin e planeve të integritetit, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe mirëqeverisjes vendore.
- U forcua Këshilli Konsultativ dhe dialogu qendror-vendor, si dhe u përmirësua monitorimi i projekteve me financim të huaj përmes sistemeve të raportimit dhe transparencës.

Sfidat kryesore

- Qartësimi i kompetencave të këshillave bashkiakë dhe mekanizmave të konsultimit publik mbetet i kufizuar, për shkak të mbivendosjeve ligjore ndërmjet niveleve të qeverisjes.
- Demokracia vendore dhe integrimi evropian mbeten fusha me numër më të kufizuar masash dhe me nevojë për mbështetje më të madhe strukturore.
- Kapacitetet e bashkive për përfitimin nga fondet dhe programet evropiane janë të pabarabarta, veçanërisht në bashkitë e vogla.
- Pavarësisht forcimit të Këshillit Konsultativ, ndikimi i rekomandimeve të tij në proceset e vendimmarrjes mbetet ende i kufizuar.

QP6. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve

Niveli i realizimit për vitin 2024: 73%

Arritjet kryesore

- U realizua rritja e pagave për nëpunësit vendorë dhe u zhvilluan 3.566 trajnime, duke kontribuar në stabilizimin dhe profesionalizimin e administratës vendore.
- 11 masa arritën realizim të plotë, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnim, funksionalizimin e platformës “Administrata.al” dhe përmirësimin e mekanizmave të bashkëpunimit institucional.
- U krijua mekanizmi pilot i decentralizimit horizontal përmes bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe institucioneve qendrore në fusha si arsimi, bujqësia dhe shëndetësia.

Sfidat kryesore

- Përdorimi efektiv i platformës “Administrata.al” dhe forcimi i strukturave të menaxhimit të burimeve njerëzore në bashki mbeten ende të kufizuara.

- Monitorimi i strukturave territoriale nga Prefekti vijon të ketë kufizime për shkak të kuadrit aktual ligjor dhe ndarjes së kompetencave.
- Akademia e Trajnimit për pushtetin vendor është në proces konsolidimi dhe kërkon institucionalizim të plotë.

Përfundime

- ✓ Rezultatet e vitit 2024 tregojnë se procesi i zbatimit të SNDQV ka kaluar nga faza e ngritjes dhe organizimit institucional në një fazë ku theksi është te produktet, rezultatet dhe standardizimi i proceseve. Me 57 masa të finalizuara dhe shumicën e të tjerave në zbatim, viti 2024 paraqet ritmin më të stabilizuar në dy vitet e para të Strategjisë.
- ✓ QP2 dhe QP6 shfaqin ritmin më të shpejtë të progresit, është një tregues i qartë se fushat ku ka bashkëpunim më të mirë ndërministror dhe më shumë strukturë metodologjike avancojnë më shpejt. Objektivat që lidhen me financat dhe decentralizimin horizontal mbeten më sfidues, duke reflektuar kompleksitet më të lartë dhe varësi të ndërsjella institucionale.
- ✓ Raporti nënvizon se cilësia e të dhënave të raportuara nga NJVV-të dhe institucionet qendrore është e ndryshueshme, dhe në disa raste kufizuese. Përmirësimi i saj mbetet një kusht i domosdoshëm për monitorim efektiv, vendimmarrje të bazuar në evidencë dhe përmirësim të qeverisjes vendore.
- ✓ Në disa fusha, si arsimi parashkollor dhe shërbimet sociale, shënohen hapa të rëndësishëm përpara, të reflektuar edhe në progresin e dokumentuar të masave përkatëse. Megjithatë, disa procese mbeten vetëm pjesërisht të zbatuara dhe kërkojnë një kornizë më të mirë të monitorimit dhe kordinimit ndërsektorial.
- ✓ Pavarësisht përmirësimeve në raportim dhe mekanizmave të rakordimit (p.sh. renta minerare), indikatorët e autonomisë fiskale nuk tregojnë avancime të krahasueshme me shtyllat e tjera. Shumë bashki vazhdojnë të mos kenë kapacitetin e duhur për huamarrje, përgatitje projekt-ideje dhe menaxhim financiar.
- ✓ Aktivizimi i forumeve tematike profesionale, rritja e rolit të Këshillit Konsultativ dhe forcimi i koordinimit me donatorët tregojnë një angazhim më të madh institucional dhe praktik në proceset e decentralizimit. Kjo është një arritje strukturore që pritet të japë efekte afatgjata.
- ✓ Sektori i burimeve njerëzore ka bërë hapa të rëndësishëm përpara, falë trajnimeve, ngritjes së kapaciteteve dhe platformave digjitale, duke e kthyer QP6 në një nga shtyllat më të suksesshme të raportit.
- ✓ Masat e ndërlydhura me rolin e qarqeve, planifikimin ndër-rajonar dhe funksionet që mbështeten nga disa institucione njëkohësisht, kanë ecuri më të ulët ose të pamjaftueshme.
- ✓ Viti 2024 shërben si një vit kyç për përgatitjen e mbylljes së Planit të Veprimit 2023-2025. Duke qenë se ritmi i zbatimit është përmirësuar, ka bazë reale që viti 2025 të ofrojë një paraqitje më të mirë të arritjeve strukturore, me kusht që të adresohen zonat e mbetura problematike.

Rekomandime

- Të standardizohen format, frekuenca dhe cilësia e raportimit nga NJVV-të, duke vendosur udhëzues të njëjtë për të gjitha institucionet.
- Të rritet përdorimi i platformave digjitale për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, për të rritur transparencën dhe për të lehtësuar monitorimin e indikatorëve të performancës.
- Të finalizohet unifikimi i AFMIS në nivel vendor dhe të sigurohet asistencë për bashkitë me kapacitet më të ulët teknik.
- Të integrohen më shumë shërbime vendore në platformat ekzistuese digjitale, duke reduktuar procedurat manuale dhe duke rritur efikasitetin.
- Të institucionalizohen programet e trajnimit afatgjatë për burimet njerëzore, jo vetëm për përdorimin e platformave, por edhe për planifikim strategjik, menaxhim financiar dhe matje të performancës.
- Të forcohen njësitë e menaxhimit të performancës në bashki për të garantuar cilësi më të lartë të raportimit dhe vendimmarrjes.
- Të ofrohet asistencë teknike për NJVV-të në procesin e huamarrjes vendore, hartimin e projekteve kapitale dhe menaxhimin e të ardhurave.
- Të përforcohet roli i bashkive në rakordimin e të ardhurave të deleguara (p.sh. renta minerare), duke reduktuar vonesat dhe mospërputhjet.
- Të forcohet roli operativ i Këshillit Konsultativ në monitorimin e ligjeve dhe politikave që ndikojnë në funksionet vendore.
- Të rritet bashkërendimi midis ministrive sektoriale dhe AMVV-së për të shmangur mbivendosjet dhe boshllëqet në procesin e decentralizimit.
- Të përgatitet një plan i integruar për decentralizimin e funksioneve të mbetura kritike (si roli i qarqeve, funksionet horizontale, disa segmente të planifikimit territorial).
- Të përmirësohen mekanizmat e monitorimit të funksioneve të reja të decentralizuara, sidomos në arsimin parashkollor dhe shërbimet sociale.
- Të zgjerohet përdorimi i platformave të konsultimit publik dhe publikimit proaktiv të informacionit financiar dhe të performancës nga bashkitë.
- Të rritet roli i forumeve profesionale dhe organizatave vendore si burime eksperte në hartimin e politikave dhe vendimmarrje.
- Të ndërtohen mekanizma diferencues mbështetjeje për bashkitë me performancë më të ulët, për të ulur diferencat e mëdha në zbatimin e masave strategjike.
- Të konsiderohet krijimi i një modeli mentorimi/konsulencë ndërmjet bashkive me performancë të lartë dhe atyre në vështirësi.

 1	 2	 3	 4	 5	 6
1.1.1	2.1.1	3.1.1	4.1.1	5.1.1	6.1.1
1.1.2	2.1.2	3.2.1	4.1.2	5.1.2	6.1.2
1.1.3	2.1.3	3.2.2	4.1.3	5.1.3	6.1.3
1.1.4	2.1.4	3.2.3	4.1.4	5.2.1	6.1.4
1.1.5	2.2.1	3.2.4	4.1.5	5.2.2	6.1.5
1.1.6	2.2.2	3.2.5	4.1.6	5.2.3	6.1.6
1.2.1	2.2.3	3.2.6	4.1.7	5.3.1	6.1.7
1.2.2	2.2.4	3.2.7	4.1.8	5.3.2	6.1.8
1.2.3	2.2.5	3.2.8	4.1.9	5.3.3	6.1.9
1.2.4	2.2.6	3.2.9	4.1.10	5.3.4	6.1.10
1.2.5	2.2.7	3.2.10	4.1.11		6.1.11
1.2.6	2.2.8	3.2.11	4.1.12		6.2.1
1.2.7	2.2.9	3.2.12	4.1.13		6.2.2
1.2.8	2.2.10		4.1.14		6.2.3
1.2.9	2.2.11		4.1.15		6.2.4
1.3.1	2.2.13		4.2.1		6.2.5
1.3.2	2.2.14		4.2.2		6.3.1
1.3.3	2.2.15		4.2.3		6.3.2
1.3.4	2.2.16		4.3.1		6.4.1
1.3.5	2.2.17		4.4.1		6.4.2
1.3.6	2.2.18		4.4.2		6.5.1
1.3.7	2.2.19		4.4.3		6.5.2
1.3.8	2.2.20		4.4.4		6.5.3
1.3.9	2.2.21		4.4.5		
1.3.10	2.2.22		4.4.6		
1.3.11	2.2.23		4.4.7		
1.3.12	2.2.24		4.4.8		
1.4.1	2.2.25		4.4.9		
1.4.2	2.2.26		4.4.10		
1.4.3	2.2.27		4.4.11		
1.4.4	2.2.28		4.4.12		
	2.2.29		4.4.13		
	2.2.30		4.4.14		
	2.2.31				
	2.2.32				
	2.2.33				
	2.2.34				
	2.2.35				
	2.2.36				
	2.2.37				
	2.2.38				
	2.2.39				
	2.2.40				
	2.2.41				
	2.2.42				
	2.2.41				
	2.2.42				
	2.2.43				
	2.2.44				
	2.2.45				
	2.2.46				
	2.2.47				
	2.2.48				
	2.2.49				
	2.2.50				
	2.2.51				
	2.3.1				
	2.3.2				
	2.3.3				
	2.3.4				
	2.3.5				
	2.3.6				
	2.3.7				
	2.3.8				
	2.3.9				
	2.4.1				
	2.4.2				
	2.4.3				

Paraqitja grafikiisht e masave me ngjyrë sipas nivelit të realizimit

Ankes 1

Qëllimi politik I

1.1.1 “Përfundimi i procesit të hartimit të planeve të përgjithshme vendore, rishikimi i planeve të miratuara dhe hartimi i planeve strategjike zhvillimore” Realizueshmëria 90%, ngjyra jeshile.

1.1.2 “Rijetëzimi dhe prezantimi i incentivave apo skemave të reja për marrëveshjet ndërvendore dhe me aktorë të tjerë joqeveritare” Realizueshmëria 90%, ngjyra jeshile.

1.1.3 “Rishikim i kuadrit ligjor mbi skemat vendore/praktikave ekzistuese të mbështetjes dhe bashkëpunimit me biznese” Realizueshmëria 35%, ngjyra portokalli.

1.1.4 “Qartësim i hapësirave/mbivendosjeve ligjore lidhur me rijetëzimin e shoqërive tregtare” Realizueshmëria 35%, ngjyra portokalli.

1.1.5 “Hartimi i një udhërrëfyese për bashkitë mbi mbështetjen e bizneseve vendore me grante apo shërbime të tjera” Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe.

1.1.6 “Identifikimi i vazhdueshëm i praktikave të mira të lidhura me bashkëpunimin bashki-biznes dhe inkurajimi e orientim i bashkive për replikim apo përshtatje sipas rastit” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

1.2.1 “Shfrytëzimi i aseteve vendore, si instrument i rritjes ekonomike vendore dhe burim i gjenerimit të të ardhurave. Identifikim, vlerësim dhe klasifikim të pronave të bashkive (inventarizim nga secila bashki)” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

1.2.2 “Strategji/Plan të vënies në përdorim të aseteve vendore nga ana e bashkive (përcaktimin e burimeve financiare dhe politikave fiskale që mbështesin zbatimin e strategjisë/planit)” Realizueshmëria 40%, ngjyra portokalli.

1.2.3 “Bashkëpunim të zgjeruar ndërinstitucional në lehtësimin e procesit të transferimit të pronave publike tek NJVV me qëllim rritjen e ekonomisë vendore” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

1.2.5 “Rijetëzimi i aseteve natyrore (si pyjet dhe kullotat apo fondi i tokës bujqësore)” Realizueshmëria 60%, ngjyra jeshile.

1.2.6 “Koordinim ndërbashkiak në drejtim të planeve të përbashkëta të mbarështimit të pyjeve me qëllim zhvillimin ekonomik vendor” Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli.

1.2.7 “Hartim i metodologjisë për vlerësimin e kapitalit natyror” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

1.2.8 “Vlerësimi i kapitalit natyror për secilën bashki sipas metodologjisë së miratuar” Realizueshmëria 45%, ngjyra portokalli.

1.2.9 “Hartim i planit të menaxhimit të kapitalit natyror për secilën bashki” Realizueshmëria 45%, ngjyra portokalli.

1.3.1 “Nxitja e rolit të bashkisë për mbështetjen nëpërmjet financimit me grante dhe lehtësimi për aplikimin në skemat e AZHBR-së” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

1.3.2 “Ngritja e kapaciteteve të bashkive në procesin e krijimit të Grupeve Vendore të Veprimit në kuadrin e masës LEADER të programeve IPARD” Realizueshmëria 60%, ngjyra jeshile.

1.3.3 “Nxitja e rolit të bashkive dhe konsolidimi i kapaciteteve të tyre në administrimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit, duke e mbështetur edhe nëpërmjet financimeve nga qeveria qendrore, si dhe fuqizimin e bashkërendimit të politikave për zhvillimin e rrjeteve parësore nën administrimin e MBZHR-së, atyre dytësore dhe tretësore nën kompetencën bashkiake” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

1.3.4 “Organizimi dhe funksionimi i strukturave përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, sigurinë e digave dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja, në pronësi të NJVV. (Krijimi dhe konsolidimi i Njesisë Përgjegjëse për Ujitjen dhe Kullimin (NJPUK), ku bën pjesë edhe Njësia e Drejtimit Teknik të Digave)” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

1.3.5 “Kryerja e studimit të parafisibilitetit të rreth 430 digave për sigurinë e digave dhe përdorimit të tyre për ujitje, mbështetur në studimet e mëparshme (për 195 diga) të sigurisë së digave” **Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli.**

1.3.6 “Rritja e sigurisë së digave, nëpërmjet rehabilitimit/rikonstruksionit të digave, duke filluar nga ato me rrezikshmëri të lartë” **Realizueshmëria 49%, ngjyra portokalli.**

1.3.7 “Ofrimi i shërbimit të qëndrueshëm të ujitjes në sipërfaqen potencialisht të ujitshme 360,000 ha. (Vazhdimi i ujitjes së qëndrueshme në rreth 250,000 ha me infrastrukturë ujitëse të rehabilituar plotësisht/pjesërisht dhe shtimi i aftësisë ujitëse me rreth 110,000 ha, kryesisht në skemat ujitëse me ngritje mekanike me stacione pompimi)” **Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.**

1.3.8 “Ofrimi i shërbimit të qëndrueshëm të kullimit në sipërfaqen potencialisht të kullueshme në 280,000 ha (Vazhdimi i procesit ciklik vjetor të pastrimit të rrjetit të kanaleve kulluese, të parët nga MBZHR-ja dhe të dytë, e të tretë nga NJVV-të, si dhe përmirësimi teknik i hidrovoreve)” **Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.**

1.3.9 “Përmirësimi i sigurisë së mbrojtjes nga përmbytja (Nëpërmjet rehabilitimit dhe ndërtimit të argjinaturave të mbrojtjes nga përmbytja, për tokat bujqësore dhe zonat rurale nga MBZHR-ja dhe zonat urbane nga NJVV)” **Realizueshmëria 75%, ngjyra jeshile.**

1.3.10 “Performanca e ofrimit të shërbimit të ujitjes dhe të kullimit nga NJVV, nëpërmjet popullimit me të dhëna të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Ujitjes dhe të Kullimit nga vetë NJVV (ujitja.al) dhe vlerësimi i performances” **Realizueshmëria 65%, ngjyra jeshile.**

1.3.11 “Qartësimi i kompetencave për sanksione administrative direkte për bashkitë në lidhje me shkeljet në mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve e kullotave” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

1.3.12 “Promovimi i nismave në nivel bashkie dhe qarku për mbarështimin e pyjeve dhe ruajtjen e tyre” **Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.**

1.4.1 “Fuqizimi i strukturave të turizmit vendor në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor” **Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.**

1.4.2 “Rishikimi i kuadrit ligjor mbi Trashëgiminë Kulturore” **Realizueshmëria 40%, ngjyra jeshile.**

1.4.3 “Ngritja e një sistemi/databazë të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

1.4.4 “Aplikimi i instrumenteve inovative si zonat e përmirësimit të biznesit dhe turizmit” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

Qëllimi politik II

2.1.1 “Vlerësim/Studim mbi efikasitetin e ofrimit të shërbimeve të ushtruara nga bashkitë” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.1.2 “Studim/Analizë e përditësuar e harmonizimit ligjor, duke përfshirë mbivendosjet dhe hapësirat potenciale midis ligjit organik dhe atyre sektoriale” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.1.3 “Harmonizim i ligjeve dhe akteve nënligjore që përcaktojnë marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore për forcimin e rolit të NJVV në zbatimin e funksioneve” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.1.4 “Përgatitja e manualeve, rregulloreve, modeleve, planeve të përmirësimit të shërbimit (të përzgjedhura) që i shërbejnë organizimit të brendshëm të NJVV për një ofrim sipas standardeve të shërbimeve” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.2.1 “Harmonizimi ligjor për kompetencat e NJVV-ve për shërbimet e UKN” Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli.

2.2.2 “Hartimi i planeve 5-vjeçar të biznesit për të gjitha ndërmarrjet rajonale UKN sh. a, në konsultim me NJVV-të” Realizueshmëria 80%, ngjyra jeshile.

2.2.3 “Asistencë teknike për NJVV-të për rishikimin e tarifave të ujit të përdorur, në kuadër të reformës së rajonalizimit të UKN sh.a.” Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.

2.2.4 “Hartimi i kuadrit rregullator për përcaktimin e kriterëve dhe rregullimi i mbrojtjes së burimeve ujore të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm” Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.

2.2.5 “Rishikimi i kuadrit rregullator për arsimin me qëllim përfshirjen e vetëqeverisjes vendore në të gjitha proceset e arsimit parashkollor, përmes një procesi gjithëpërfshirës” Realizueshmëria 80%, ngjyra jeshile.

2.2.6 “Avancimi i decentralizimit të funksionit të arsimit parashkollor duke i dhënë kompetenca bashkive a) hartimin e politikave nga qeverisja vendore, b) të përshtatin funksionin me rrethanat vendore dhe c) të përfshijë aktorët lokalë (si këshillat e prindërve) në procesin e vendimmarrjes” Realizueshmëria 70%, ngjyra portokalli.

2.2.7 “Krijimi i “Konferencës Ndërbashkiake për Arsimin Parashkollor” si organ vendor ose rajonal për të koordinuar bashkitë, (ose si një grup pune i Shoqatave të Bashkive) me qëllim diskutimin e problemeve dhe projekteve të përbashkëta” Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli.

2.2.8 “Përcaktimi i skemës së kompensimit financiar dhe mbulimit të shpenzimeve të transportit për nxënësit që ndjekin procesin mësimor në institucionet e arsimit parashkollor publike, jashtë vendbanimit” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.2.9 “Rritja e rolit të pjesëmarrjes së prindërve në edukimin parashkollor përmes fuqizimit të bordeve dhe fushatave të dedikuara informuese” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.2.10 “Rritja e kapaciteteve të administratës vendore për menaxhimin e shërbimit të arsimit parashkollor përmes një kurrikule dhe sistemi certifikimi të njehsuar” Realizueshmëria 40%, ngjyra portokalli.

2.2.11 “Asistencë teknike dhe financiare për NJVV për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve, përfshirë mbledhjen e të dhënave (procedurat standarde të veprimit në arsimin

parashkollor, vlerësimi i performancës së drejtorëve të kopshtit, planet e përmimirësimit të shërbimit, etj.)” Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.

2.2.13 “Rishikim i bazës ligjore për lejet e mjedisit për të përcaktuar përgjegjësitë dhe kompetencat bashkiake rregullatore dhe monitoruese për aktivitetet industriale që kanë një ndikim relativisht të ulët në mjedis dhe që zhvillohen në zona urbane, jashë zonave industrial”:

Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.2.14 “Rishikimi i kompetencës bashkiake për monitorim dhe sanksione administrative direkte lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe kompetencës vendore në fushën e mbrojtjes nga ndotja e ajrit, ujit dhe akustike” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.2.15 “Mbështetje dhe rritje kapacitetesh për planet vendore të veprimit për mjedisin dhe të cilësisë së ajrit, si dhe strukturat përkatëse” Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.

2.2.16 “Mbështetje dhe rritje kapacitetesh për mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi” Realizueshmëria 30% ngjyra portokalli.

2.2.17 “Vlerësim strategjik të mjedisit të secilës bashki (identifikim i problemeve mjedisore, përditësim i zonave të ndjeshme ku ndodhen ndërtesat me kërkesa të veçanta për nivelin e zhurmave, përcaktim i objektivave vendore të mjedisit për secilën bashki, etj.)” Realizueshmëria 45%, ngjyra portokalli.

2.2.18 “Nisma për edukimin ambientel të komunitetit (rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim, hedhjen e tyre me orar si edhe përdorimi i çantave ekologjike të riciklueshme, të cilat përmirësojnë dhe mbrojnë mjedisin urban)” Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.

2.2.19 “Studimi për përcaktimin e zonave të mbetjeve dhe modelit institucional të qeverisjes dhe organizimit të Zonave të Mbetjeve dhe rolin e NJVV-ve” Realizueshmëria 85%, ngjyra jeshile.

2.2.20 “Studim dhe asistencë teknike për qartësimin dhe negocimin e marrëdhënieve kontraktuale të NJVV-ve me qeverinë qendrore dhe impiantet e trajtimit të mbetjeve përfshirë dhe rishikimin e kuadrit rregullator” Realizueshmëria 90%, ngjyra jeshile.

2.2.21 “Asistencë teknike dhe financiare për NJVV për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve, përfshirë edhe mbledhjen e diferencuar dhe riciklimin (planet e menaxhimit të mbetjeve, paketa fiskale, etj.)” Realizueshmëria 100 %, ngjyra jeshile.

2.2.22 “Hartimi i kuadrit rregullator për zbatueshmërinë e parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për bashkitë dhe qarqet” Realizueshmëria 90% ngjyra jeshile.

2.2.23 “Konceptimi dhe hartimi i masave nxitëse fiskale dhe financiare për aktivitetet ricikluese dhe kompostuese në nivel vendor” Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.

2.2.24 “Fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për mobilizimin e komunitetit për ndarjen në burim dhe monitorimin e cilësisë së shërbimit” Realizueshmëria 100 %, ngjyra jeshile.

2.2.25 “Ngritja e burimeve njerëzore në nivel teknik e menaxherial për menaxhimin e shërbimit të mbetjeve përmes një kurrikule dhe sistemi certifikimi të njehsuar” Realizueshmëria 50% ngjyra e jeshile.

2.2.26 “Hartimi i raportit të vlerësimit për mbikëqyrjen së siguri së digave dhe rolin e NJVV” Realizueshmëria 100 % ngjyra jeshile.

2.2.27 Harmonizimi i kuadrit rregullator për menaxhimin e burimeve ujore vendore” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.2.29 “Hartimi dhe miratimi i projekteve për ndërtimin dhe funksionimin e terminaleve të udhëtarëve dhe autobuseve të shërbimit të transportit publik vendor” Realizueshmëria 40%, ngjyra portokalli.

2.2.30 “Miratimi nga bashkitë i politikave dhe nxitësve financiarë vendorë për autobusët urbanë elektrike dhe taksitë ekologjike/elektrike” Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.

2.2.31 “Zhvillimi i mekanizmave rregullatorë dhe financiarë për të nxitur bashkëpunimet ndërvendore për transportin publik vendor dhe lëvizshmërinë aktive” Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.

2.2.32 “Studimi për mekanizmin e Fondit Social dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel bashkie/qarku si edhe gjithë aktorëve në përdorimin efektiv të Fondit Social” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

2.2.33 “Plotësimi i kuadrit rregullator për prokurimin e shërbimeve sociale (manual dhe udhëzues) dhe bashkëpunimin me aktorë publikë e private” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

2.2.34 “Mbështetja për fuqizimin e NJVNR-ve për menaxhimin e rasteve në mënyrë graduale në të gjitha njësitë vendore” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

2.2.35 “Rritje kapaciteteve për stafet vendore për menaxhimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve, përfshirë nënkontraktimin e kujdesit social bazuar në modele, sigurimin e cilësisë dhe inspektimin” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

2.2.36 “Identifikimi dhe planifikimi i shërbimeve të nevojshme në nivel bashkie e qarku për gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit dhe PAK (shërbime të specializuara)”: **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

2.2.37 “Ngritja e shërbimeve të specializuara në mbështetje të reformës PAK dhe përmirësimi i aksesit fizik në këto shërbime, shoqëruar me paketën për referim dhe ofrim të rehabilitimit, si edhe riaftësimin e tyre”: **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

2.2.38 “Mbështetje dhe bashkëpunimi proaktiv me SHSSH, AKPA për aktivizimin e të përfutuesve të NE-së në moshë pune dhe referimin në shërbime sociale”: **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

2.2.39 “Ngritje e kapaciteteve për stafet vendore për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe protokollet përkatëse, koordinim me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve” **Realizueshmëria 80%, ngjyra jeshile.**

2.2.40 “Ngritja dhe përdorimi i sistemit të mbledhjes sistematike të të dhënave në lidhje me strehimin social në disa bashki pilot” **Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.**

2.2.41 “Hartimi i planeve të strehimit social dhe monitorimi periodik i zbatimit të tyre”: **Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.**

2.2.42 Rritja e mbulimit të programeve të strehimit social” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

2.2.42 “Identifikimi dhe hartëzimi i proceseve në të gjitha nivelet e strukturave të MZSH-së me qëllim propozimin e sistemeve inovative për lehtësimin e procesve të punës, monitorimin në kohë reale dhe ofrimin e shërbimeve online për qytetarët” **Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.**

2.2.43 “Identifikimi i projekteve që do të mundësonin digjitalizimin e shërbimit të MZSH-së lidhur me thirrjet e adresuara të numri unik 128” **Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.**

2.2.44 “Hartimi i dokumenteve të strategjisë për zvogëlimin dhe vlerësimin e riskut në nivel vendor (plani kombëtar i emergjencave civile dhe plan operacional)” **Realizueshmëria 18%, ngjyra portokalli.**

2.2.45 “Hartimi i planit vendor për emergjencat civile” **Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.**

2.2.46 “Krijimi i bazës së të dhënave në nivel vendor për emergjencat civile” **Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.**

2.2.47 “Forcimi i strukturës vendore për mbrojtjen civile” **Realizueshmëria 40%, ngjyra portokalli.**

2.2.48 “Trajnimi i punonjësve të NJVV dhe grupeve vullnetare komunitare për përballimin e situatave të fatkeqësive natyrore” **Realizueshmëria 65%, ngjyra jeshile.**

2.2.49 “Hartimi i akteve nënligjore në plotësim të ligjit të ri të Policisë Bashkiake” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

2.2.50 “Plotësimi i kuadrit rregullator të funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike” **Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.**

- 2.2.51 “Nxitja për forcimin e kapaciteteve administrative dhe trajnimi i punonjësve të policisë bashkiake” **Realizueshmëria 75%, ngjyra jeshile.**
- 2.3.1 “Hartëzim i të gjithë standardeve të shërbimeve të ofruara nga bashkitë, duke i ndarë sipas llojit të standardeve (teknike, administrative, shërbimi)” **Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli.**
- 2.3.2 “Hartimi i metodologjisë për vendosjen e standardeve kombëtare minimale për shërbime të përzgjedhura” **Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.**
- 2.3.3 “Prioritizim i një liste standardesh minimale kombëtare dhe koordinim i procesit për vendosjen e tyre” **Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.**
- 2.3.4 “Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimit të arsimit parashkollor dhe kostimi i tyre” **Realizueshmëria 65%, ngjyrë jeshile.**
- 2.3.5 “Përcaktimi i kostove për njësi për shërbimet e kujdesit social si edhe hartimi i standardeve të reja dhe riorganizimi i standardeve ekzistuese në fushën e shërbimit të kujdesit social” **Realizueshmëria 70%, ngjyrë jeshile, masa e realizuar për vitin e dytë të planit të veprimit.**
- 2.3.6 “Hartimi dhe miratimi i paketës së plotë të standardeve minimale kombëtare për ofrimin e shërbimeve UKN” **Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli.**
- 2.3.7 “Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimit të mbetjeve dhe kostimi i tyre” **Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.**
- 2.3.8 “Studim fizibiliteti për standardet minimale kombëtare për ofrimin e shërbimeve të transportit publik vendor dhe politikat sociale (tarifat e lehtësuara)” **Realizueshmëria 60%, ngjyra jeshile.**
- 2.3.9 “Hartimi dhe miratimi i standardeve për ndërtimin dhe funksionimin e stacioneve multimodale të mjeteve të transportit publik vendor” **Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.**
- 2.4.1 “Ndërtimi i një sistemi bazuar mbi performancë mbështetur në tregues të matshëm e të verifikueshëm” **Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.**
- 2.4.2 “Përshtatja e kuadrit normativ për ndërtimin e një sistemi të bazuar në performance” **Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.**
- 2.4.3 “Hartimi i udhëzuesve për ngritjen e Njësive të Performancës në nivel bashkie dhe rritja e kapaciteteve për përdorimin e tij” **Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.**

Qëllimi politik III

- 3.2.1 “Implementimi i shërbimeve elektronike në platformën e-Albania” **Realizueshmëria 50%, ngjyra portokalli.**
- 3.2.2 “Implementimi i sistemit të trajtimit dhe menaxhimit të aplikimeve” **Realizueshmëria 50%, ngjyra portokalli.**
- 3.2.3 “Krijimi i sistemit elektronik të rekordeve dhe dokumenteve elektronike” **Realizueshmëria 65%, ngjyra jeshile.**
- 3.2.4 “Implementimi i sistemit e-inspektimi” **Realizueshmëria 35% ngjyra portokalli.**
- 3.2.5 “Sistemi e-gjopa për Policinë Bashkiake” **Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.**
- 3.2.6 “Ngritja e sistemit online të taksave dhe tarifave vendore” **Realizueshmëria 35% ngjyra portokalli.**
- 3.2.7 “Ngritja e sistemit financiar për menaxhimin e kontabilitetit dhe magazinës” **Realizueshmëria 35% ngjyra portokalli.**
- 3.2.8 “Implementimi i faqeve zyrtare (ëbsite) të reja dhe unifikuara të çdo bashkie” **Realizueshmëria 55%, ngjyra portokalli.**
- 3.2.9 “Implementimi i sistemit për menaxhimin e punëve publike” **Realizueshmëria 35%, ngjyra portokalli.**

3.2.10 “Ngritja e sistemit të akteve elektronike të Këshillit Bashkiak dhe botimit të tyre” **Realizueshmëria Realizueshmëria 35%, ngjyra portokalli.**

3.2.11 “Ngritja e infrastrukturës hardëare të qendëruar për sistemet TIK të pushtetit vendor” **Realizueshmëria 35%, ngjyra portokalli.**

Qëllimi politik IV

4.1.1 “Rritja e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme” **Realizueshmëria 51%, ngjyra portokalli.**

4.1.2 “Popullimi dhe përditësimi i kadastrës fiskale” **Realizueshmëria 51%, ngjyra jeshile.**

4.1.4 “Ngritja e një sistemi monitorimi për taksën e pasurisë së paluajtshme” **Realizueshmëria 51%, ngjyra jeshile.**

4.1.6 “Zbatimi i ndarjes së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.**

4.1.8 “Zbatimi i ndryshimeve të nevojshme (ndërlidhja) në sistemin informatik të administratës tatimore qendrore për të mundësuar identifikimin e plotë të rezidencës së tatimpaguesve” **Realizueshmëria 50%, ngjyra portokalli.**

4.1.9 “Ndryshimi i kuadrit ligjor për të reflektuar rritjen e pjesës takuese të njësive të vetëqeverisjes vendore nga renta minerare nga niveli aktual prej 5% në 8%” **Realizueshmëria 10%, ngjyra portokalli.**

4.1.10 “Ngritja e një sistemi raportimi dhe rakordimi midis administratës qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për masën e rentës minerare të pagueshme” **Realizueshmëria 90 %, ngjyra jeshile.**

4.1.11 “Studimi fizibiliteti për ndarjen e të ardhurave nga tatime të tjera kombëtare (taksat e përbashkëta)” **Realizueshmëria 10%, ngjyra portokalli.**

4.1.13 “Brenda politikave kombëtare makroekonomike e fiskale, në limitin vjetor të huamarrjes publike të përcaktohet një hapësirë e dedikuar për qeverisjen vendore” **Realizueshmëria 70%, ngjyra portokalli.**

4.1.14 “Studimi i fizibilitetit për Sistemin MIS të unifikuar të tatimeve (TAIS), përfshirë modul për menaxhimin financiar të aseteve” **Realizueshmëria 10%, ngjyra portokalli.**

4.1.15 Hartimi i konceptit dhe termave të referencës për TAIS **Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.**

4.2.1 “Integrimi i transfertave specifike në transfertën e pakushtëzuar (të përgjithshme dhe sektoriale) për menaxhimin e funksioneve. Transferimi i granteve të përgjithshme dhe granteve sektoriale” **Realizueshmëria 50%, ngjyra portokalli.**

4.2.2 “Hartimi i një studimi mbi funksionet vendore që financohen me transferata të kushtëzuara, nevojat e bashkive për financim dhe mundësitë e financimit” **Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli.**

4.2.3 “Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për financimin me grante të kushtëzuara të funksioneve vendore apo projekteve kapitale në sektorë strategjikë për njësitë e vetëqeverisjes vendore” **Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli.**

4.3.1 “Financimi nëpërmjet huamarrjes së njësive të qeverisjes vendore” **Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.**

4.4.2 “Hartimi i konceptit të detajuar për AFMIS dhe detajimi i zgjidhjes informatike dhe termat e referencës për ndërtimin e sistemit” **Realizueshmëria 40%, ngjyra portokalli.**

4.4.4 “Përmirësimi/konsolidimi i procesit të buxhetimit PBA në të gjitha NJVV-të” **Realizueshmëria 80% ngjyra jeshile.**

4.4.5 “Rishikimi i klasifikimit buxhetor për NJQV dhe lidhja me funksionet” **Realizueshmëria 80% ngjyra jeshile.**

4.4.6 “Forcimi dhe zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimi i përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë vendore” **Realizueshmëria 85% ngjyra jeshile**, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

4.4.7 “Rishikimi i kuadrit rregullator në drejtim të procesit të menaxhimit të aktiveve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në kuadrin rregullator të kontabilitetit të sektorit publik mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e secilës strukture të NJVV” **Realizueshmëria 20% ngjyra portokalli**.

4.4.8 “Vlerësimi i aspekteve teknike për automatizimin e procesit të menaxhimit të aseteve vendore (në kuadrin e zgjerimit të SIMF në nivel vendor) të integruar me informacionin financiar periodik dhe vjetor mbi aktivet afatgjata të SIFQ” **Realizueshmëria 20% ngjyra portokalli**.

4.4.10 “Kompletimi i regjistrit të plotë dhe të saktë të aktiveve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet implementimit të kontabilitetit mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në procesin e menaxhimit të aktiveve në sektorin publik (inventarizim, vlerësim, nxjerrje jashtë përdorimi)” **Realizueshmëria 20% ngjyra portokalli**.

4.4.11 “Përfshirja në SIFQ e kërkesave të NJVV për kontabilitetin rritës, menaxhimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe raportet financiare periodike dhe vjetore. Përkohë me procesin e zhvillimit /zgjerimit të mëtejshëm të SIFQ.”: **Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli**.

4.4.12 “Vlerësimi i aspekteve teknike për ndarjen e llogarive vendore në Llogari të Unifikuar të thesarit” **Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe**.

4.4.13 “Identifikimi (ndarja) e llogarive vendore” **Realizueshmëria 0% ngjyra e kuqe**.

4.4.14 “Forcimi i kapaciteteve vendore për menaxhimin e likuiditetit” **Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli**.

Qëllimi politik V

5.1.1 “Konsolidimi i rolit të NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mbivendosjet ligjore dhe administrative në marrëdhëniet me qeverisjen qendrore (kompetencat e Këshillit Bashkiak, konsultimi publik dhe vendimarrja e qytetarit)”: **Realizueshmëria 55%, ngjyra jeshile**.

5.1.2 “Ndërtimi i një mekanizmi nxitës për rritjen e efikasitetit të Këshillave Bashkiakë duke pasur parasysh performancën e tij, komisionet bashkiake dhe aspekte të tjera lidhur me transparencën dhe llogaridhënien, duke marrë në konsideratë integrimin me bazë gjinore”: **Realizueshmëria 85%, ngjyra jeshile**.

5.1.3 “Forcimi i kapaciteteve të Këshillave Bashkiak dhe inkurajimi i shkëmbimit të praktikave të mira mbi transparencën, llogaridhënien dhe vendimarrja mbi bazën e parimit të subsidiaritetit” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile**.

5.2.1 “Koordinimi dhe bashkërendimi me NJVV për hartimin e planeve të integritetit dhe Kodit të Sjelljes” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile**.

5.2.2 “Krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm për monitorimin e elementëve të demokracisë vendore në kuadër të programit të transparencës në nivel vendor” **Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe**.

5.3.1 “Forcimi i rolit të Njësive të BE-së për të koordinuar dhe marrë pjesë në proceset e zhvillimit të politikave bashkiake” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile**.

5.3.2 “Shtrirja e proceseve të integritetit në BE përtej Njësive të BE-së, duke siguruar përfshirjen dhe kontributin e duhur të gjithë administratës vendore” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile**.

5.3.3 “Zhvillimi i udhëzimeve ndihmuese për administratën vendore lidhur me agjendën e integritetit evropian në nivel vendor” **Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile**.

5.3.4 “Krijimi i një sistemi monitorimi dhe raportimi për projektet e zbatuara nga NJVV” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

Qëllimi politik VI

6.1.1 “Vlerësim kombëtar i nevojave për trajnim dhe trajnime të vazhdueshme bazuar në vlerësimin për trajnim” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.1.2 “Krijimi i një strukture të dedikuar të trajnimit (Akademia e Trajnimit) të administratës në nivel vendor, përfshirë të zgjedhurit vendor” Realizueshmëria 80%, ngjyra jeshile.

6.1.3 “Analiza e nivelit të pagave dhe rishikimi (rritja) e nivelit të pagave të nëpunësve në NJVV, për të siguruar qëndrueshmëri të nëpunësve ekzistues dhe tërheqjen e nëpunësve të rinj të talentuar dhe profesionistë” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.1.4 “Ngritja e kapaciteteve të nëpunësve publikë përmes zbatimit të programeve të trajnimit dhe internship-it, dedikuar nëpunësve civilë të rinj” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.1.5 “Vlerësim për përmirësimin e funksionaliteteve të platformës “Administrata.al”, për të reflektuar nevojat e institucioneve përfshirë dhe nivelin vendor për një menaxhim të unifikuar të burimeve njerëzore” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.1.6 “Vlerësimi i Nevojave për Trajnim për përdorimin e platformës “Administrata.al” për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave për trajnim të stafit në nivel qendror dhe vendor dhe hartimi i planit të trajnimeve për NJVV mbi përdorimin e portalit “Administrata.al” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.1.7 “Ngritja e kapaciteteve të Njërive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të NJVV-ve për përdorimin e platformës “Administrata.al” përmes trajnimeve dhe asistimit përmes help-desk të ngritur pranë DAP” Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile.

6.1.8 “Rritja e përdorimit të funksionaliteteve të platformës “Administrata.al”, për menaxhimin e burimeve njerëzore nga ana e NJVV përfshirë dhe raportimin periodik” Realizueshmëria 60% ngjyra jeshile.

6.1.9 “Hartimi dhe integrimi i kuadrit/kornizës së kompetencave për burimet njerëzore të NJVV në planin e trajnimit të ASPA-ës” Realizueshmëria 75%, ngjyra jeshile.

6.1.10 “Hartimi i strategjisë/planit për zhvillimin e kapaciteteve të të zgjedhurve dhe zyrtarëve të tjerë të NJVV-ve në 61 bashkitë dhe 12 këshillat e qarqeve” Realizueshmëria 80%, ngjyra jeshile.

6.1.11 “Krijimi i modeleve të matjes së performancës në nivel vendor bazuar në rezultate krahasimore” Realizueshmëria 75%, ngjyra jeshile.

6.2.1 “Identifikim dhe vlerësimi i marrëdhënieve dhe roleve të institucioneve qendrore dhe vendore në mbështetje të qeverisjes vendore” Realizueshmëria 75%, ngjyra jeshile.

6.2.2 “Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Çështjeve Vendore dhe AMVV për vlerësim, monitorim dhe zbatim të agjendës së decentralizimit” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.2.3 “Forcimi i rolit të Grupit Tematik të Decentralizimit në diskutimin e agjendës së decentralizimit dhe koordinimin me donatorët” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.2.4 “Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të funksionimit të Këshillit Konsultativ për rritjen e rolit të tij proaktiv nën dialogun ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.2.5 “Forcimi i rolit të Këshillit Konsultativ në përforcimin e dialogut ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore për koordinimin e veprimtarive dhe analizën e legjislacionit për shqyrtim, si dhe rritja e rolit të qeverisjes vendore në procesin konsultues të projekteve lidhur me standardet e shërbimeve vendore” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.3.1 “Vlerësimi i gatishmërisë për decentralizim të mëtejshëm sipas funksioneve specifike dhe tipareve të veçanta bashkiake” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.3.2 “Vlerësim dhe ridimensionim të rolit të qarqeve në kuadër të zhvillimit ndër-rajonal, nder to identifikimi i fushave me potencial për ekonomi shkalle” Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

6.4.1 “Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të institucionit të prefektit” Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

6.4.2” Forcimi i monitorimit dhe rritja e bashkëpunimit të institucionit të prefektit me degët territoriale, përfshirë edhe rolin në monitorimin e standardeve kombëtar” Realizueshmëria 55%, ngjyra jeshile.

6.5.1 “Ofrimi dhe ndarje e njohurive/eksperiencave nga shoqatat” Realizueshmëria 85%, ngjyra jeshile.

6.5.2 “Ngritja / rijetëzimi pranë shoqatave i forumeve profesionale në ndihmë të ndërveprimit mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore”: Realizueshmëria 85%, ngjyra jeshile.

6.5.3 “Konsolidimi i mekanizmit të Konkursit të Praktikave të Mira dhe inkurajimi me çmime”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe.